

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6112
E shtunë, 12 shtator 2020
çmimi 0.40 €

FSK-ja pranon donacion nga Gjermania në vlerë prej 500 mijë eurosh



FAQË 6

FLET PËR "EPOKËN E RE" KRYETARI I SBASHK-UT, RRAHMAN JASHARAJ

FAQË 4-5

JEMI GATI PËR FILLIMIN E MËSIMIT

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se janë bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor, i cili do të nisë të hënën, më 14 shtator. Jasharaj në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re" ka thënë se gjendja në shkolla është më e mirë, duke pasur parasysh angazhimin e të gjithëve që procesi mësimor të fillojë pavarësisht pandemisë Covid-19. "Në një pjesë të madhe të institucioneve janë bërë vërtet përgatitje gjatë gjithë këtyre dy javëve", ka thënë ai, duke e vlerësuar lart edhe angazhimin e Ministrisë së Arsimit dhe të ministrit Likaj. Në këtë kontekst, Jasharaj ka thënë se SBASHK-u gjatë gjithë kohës do ta monitorojë situatën në shkolla për ta parë zbatimin e masave anti-Covid. Ndërsa sa i përket cilësisë në arsim, Jasharaj ka thënë se duhet t'u kushtohet vëmendje investimeve teknologjike në shkolla.



Kosova përkujton viktimat e 11 shtatorit në ShBA

Udhëheqësit e institucioneve të Republikës së Kosovës së bashku me ambasadorin amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, të premten kanë vendosur kurora me lule pranë pllakës përkujtimore "Kosova kujton" për viktimat e 11 shtatorit në ShBA. Me rastin e 19-vjetorit të sulmeve terroriste në ShBA, homazhe janë mbajtur edhe në Bulevardin "Bill Clinton" në Prishtinë. Ndërkaq zjarrfikësit, policia dhe ambulancat kanë ndezur sirenat në kujtim të viktimateve.



Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka theksuar se partneriteti ShBA - Kosovë tekalon raportet politike

FAQË 3

Platforma e shoqërisë civile për dialog kërkon transparencë nga qeveria

FAQË 7



RENOVA
PUTZ
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRICESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.pricesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADE

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



OPINION

KUR ANALFABETËT DHE TË KORRUPTUARIT E UDHEZOJNË DRITAN ABAZOVIQIN

F. 11
Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



SHBA-ja SHËNOI PËRVJETORIN E 19 TË SULMEVE TË 11 SHTATORIT

F. 7
PESË TË VDEKUR DHE 50 RASTE TË REJA ME COVID

MERAL SADRIU-VOKSHI EMEROHET DREJTORESHË PËR BUXHET DHE FINANCA NË GJILAN

EKONOMI

ÇMIMET E KONSUMIT SHËNUAN RRITJE NË MUAJIN GUSHT

F. 8
470 BIZNESE TË REJA U REGJISTRUAN VETËM GJATË KËTIJ VITI NË FERIZAJ

SPORT

LLAPI, KAMPION I AFATIT KALIMTAR



Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ShBA-ja shënoi përvjetorin e 19 të sulmeve të 11 shtatorit

NJU JORK, 11 SHTATOR - Mijëra njerëz kanë shënuar në qytetin e Nju-Jorkut, në kryeqytetin e vendit Uashington dhe në Shanksville të Pensilvanisë, 19-vjetorin e sulmeve terroriste të vitit 2001 që lanë 3 000 persona të vrasë pas rrëmbimit të katër avionëve, dy prej të cilëve goditën kullat e Qendrës Botërore të Tregtisë, njëri Pentagonin dhe tjetri u rrëzua në një fushë në Pensilvani.

Në qytetin e Nju Jorkut

ceremonitë u zhvilluan në memorialin e 11 shtatorit, aty ku si çdo vit që nga sulmi, u lexuan emrat e viktimate përfshirë dhe ata të një sulmi në vitin 1993 ndaj Qendrës Botërore të Tregtisë. Në të gjithë qytetin e Nju-Jorkut u mbajt një moment heshtjeje në orën 8:46 të mëngjesit me orën lokale pikërisht koha kur një nga avionët u përplas me Kullën Veriore. Presidenti Donald Trump dhe

rivali i tij demokrat Joe Biden kanë përkujtuar përvjetorin e sulmeve terroriste me vizita të veçanta në Pensilvani, atje ku u rrëzua një prej avionëve të rrëmbyer.

Osama bin Laden dhe al Qaeda morën përgjegjësinë për sulmet vetëvrasëse që pasoi një luftë të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara në Afganistan. Osama bin Laden u vra nga forcat amerikane në maj të vitit 2011 në një sulm



të befashishëm në vendstrehimin e tij në Abotabad të Pakistanit duke i dhënë fund një kërkimi gati dhjetëvjeçar të udhëheqësit të al Kaedës.

Paketa e ndihmave kundër pandemisë bllokohet përsëri në Senat

UASHINGTON, 11 SHTATOR - Senati nuk arriti përsëri të enjen të miratojë një paketë të re ndihmash në përgjigje të koronavirusit, një tjetër dështim në një seri negociatash të pasuksesshme për t'u ofruar mbështetje miliona amerikanëve të goditur nga pandemia. Propozimi prej 500 miliardë dollarësh i prezantuar nga republikanët nuk arriti të kalojë në fazën e debatit pasi mori 52 vota për dhe 47 kundër. Avancimi i projektligjit kërkon mbështetje me 60 vota.



Dështimi shton shanson që ligjvënësit të mos arrijnë ta

miratojnë paketën e ndihmave para zgjedhjeve të 3 nëntorit.

Anëtarët e Kongresit pritet të largohen nga Uashingtoni përfushatat zgjedhore në shtetet përkatëse, pasi arritën miratimin e një rezolute që mundëson financimin e operacioneve të qeverisë federale pas afatit të 30 shtatorit.

Dështimi i së enjtes nënkuption që miliona amerikanë që kanë humbur punën nga mbylljet e imponuara nga pandemia në pranverë nuk do të marrin asistencë federale përpapunësinë, transmeton VOA.

Në bazë të ligjit me mbështetje dypartiake që lëvroi një paketë prej 3 trillionë dollarësh, ata që kishin humbur punën merrnin 600 dollarë në javë si asistencë papunësie. Kjo ndihmë përfundoi në fund të korrikut. Propozimi i republikanëve në Senat premtonte t'i mbulonte pagesat për asistencë papunësie, koston e çerdheve dhe kopshteve përfëmijët si dhe testet e koronavirusit dhe do të ofronte mbrojtje nga paditë gjyqësore përbizneset, shkollat dhe objektet e kultit që hapen gjatë pandemisë.

Mbretëria e Bashkuar nënshkruan marrëveshjen e parë të madhe tregtare pas Brexit-it

LONDËR, 11 SHTATOR - Mbretëria e Bashkuar ka arritur marrëveshjen e parë të madhe tregtare pas daljes nga Bashkimi Evropian (Brexit) me Japoninë. Autoritetet thanë se

marrëveshja e nënshkruar në parim ka vlerën e rreth 15 miliardë funtave.

Sekretarja britanike e Tregtisë Ndërkombëtare, Liz Truss, ka thënë se ky është një moment

istorik. Truss ka theksuar se marrëveshja do të sjellë "fitore të reja" përbizneset britanike në ushqim dhe pije, si dhe në industri të teknologjisë. Sipas kritikëve, marrëveshja mund të

ketë rëndësi simbolike, pasi ajo do ta risë brutoprodhimin e brendshëm të Mbretërisë së Bashkuar me vetëm 0,07 përqind. Marrëveshja e së premtes

ka ende nevojë përmiratim nga Parlamenti i Japonisë. Përfaqësuesit e tregtisë atje parashikojnë që marrëveshja ta marrë lejen deri në janar.



Shtetet jugore të BE-së kërcënojnë Turqinë me sanksione

BRUKSEL, 11 SHTATOR - Shtetet jugore të Bashkimit Evropian kanë njoftuar se do të hartojnë një listë të sanksioneve kundër Turqisë, nëse Ankaraja nuk vjen në tryezën e negociatave përtë zgjidhur një mosmarrëveshje territoriale me Greqinë dhe Qipron. Paralajmërimi u bë të enjten vonë, pas një samiti

joformal të të ashtuquajturit grup MED7, i kryesuar nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron.

Greqia dhe Qiproja janë në mosmarrëveshje me Ankaranë rreth rezervave të gazit natyror dhe kufijve detarë. Turqia thotë se ka të drejtë përtë kërkuar gaz në zonat që dy vendet e BE-së



thonë se janë pjesë e zonave të tyre ekskluzive ekonomike. Grupi MED7, që përfshin shtetet me vija bregdetare mesdhetare, ka njoftuar përmes një deklarate të përbashkët, se shpreh "mbështetje dhe solidaritet të plotë me Qipron dhe Greqinë, përballë shkeljeve të

përsëritura të sovranitetit të tyre, si dhe vepimeve konfrontuese të Turqisë". Pozicioni i MED7 nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin e BE-së si tërsë. Macron ka pohuar se problemi nuk qëndron te populli turk, por te Qeveria e presidentit Rexhep Tajip Erdogan.

Kosova përkujton viktimat e 11 shtatorit në ShBA

Udhëheqësit e institucioneve të Republikës së Kosovës së bashku me ambasadorin amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, të premten kanë vendosur kurora me lule pranë pllakës përkujtimore "Kosova kujton" për viktimat e 11 shtatorit në ShBA. Me rastin e 19-vjetorit të sulmeve terroriste në ShBA, homazhe janë mbajtur edhe në bulevardin "Bill Clinton" në Prishtinë. Ndërkaq zjarrfikësit, policia dhe ambulancat kanë ndezur sirenat në kujtim të viktimateve. Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka theksuar se partneriteti ShBA - Kosovë tejkalon raportet politike

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kosova ka kujtuar të premten rrëth 3 000 persona të vrarë në vitin 2001 në sulmet terroristë të Nju-Jork dhe Uashington të ShBA-së. Homazhe janë mbajtur në Bulevardin "Bill Clinton" në Prishtinë. Zjarrfikësit, policia dhe ambulancat kanë ndezur sirenat në kujtim të viktimateve. Ndërkaq në hapësirat e objektit të Qeverisë së Kosovës janë vendosur kurora me lule te memorali "Kosova kujton".

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se me shumë dhimbje kujtojnë 11 shtatorin e vitit 2001, ku nga sulmet terroristë të Qendrën Botërore të Tregtisë në Nju Jork dhe në Pentagon humbën jetën mijëra civilë të pafajshëm nga ShBA-ja dhe vende të ndryshme të botës. "Po ashtu, kujtjmë edhe heroizmin e udhëtarëve në aeroplani e United Airlines, që parandaluan një goditje tjetër terroristë duke sakrifikuar jetën e tyre me rrëzimin e këtij aeroplani në shtetin e Pensilvanisë.

Në kundërpërgjigje ndaj këtyre akteve terroristë, nën udhëheqjen e ShBA-së më pas u krijua fronti global kundër terroristët dhe ekstremizmit, ku kontribut të madh ka dhënë edhe shteti ynë", ka thënë Thaçi. Ai ka shtuar se Kosova mbetet e përkushtuar për luftimin e terroristët dhe ekstremizmit

kurdo që cenohen vlerat tonë të përbashkëta. "Sot, sikurse edhe më 11 shtator 2001, ne ndajmë dhimbjen me popullin amerikan. Populli i Kosovës dhe populli amerikan janë të lidhur ngushtë me miqësi të përjetshme dhe u jemi mirënjohës përherë për mbështetjen e dhënë në ditët më të vështira për ne", ka thënë presidenti Thaçi.

Osmani: Kosova do të qëndrojë përkrah Amerikës në luftën kundër terroristët

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, bashkë me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett, ka vendosur lule te pllaka përkujtimore me rastin e 19-vjetorit të sulmeve terroristë të ShBA-së. Para pllakës përkujtimore të 11 shtatorit, kryeparlamentarja Osmani ka thënë se janë aty për të nderuar mijëra shtetas amerikanë, në mesin e tyre edhe shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën nga një sulmi tmerrshëm terrorist 19 vjet më parë.

Osmani ka theksuar se ky sulm zgjoi ndërgjegjen e botës dhe të demokracive anekënd globit, për ta luftuar terroristët si një ndër sfidat kryesore të kohës moderne.

Kosova, sipas kryetares Osmani, do të qëndrojë përgjithmonë bashkë me popullin amerikan në kërkim të drejtësisë për ato



mijëra viktima të atij sulmi të tmerrshëm. "Kosova dhe populli i saj, si populli më proamerikan në botë dhe republika jonë, si aleatja kryesore e ShBA-së, kanë qëndruar me popullin amerikan edhe atëherë, qëndrojnë edhe sot në nderimin e viktimateve të këtij akti të shëmtuar terrorist dhe do të qëndrojë përgjithmonë bashkë me popullin amerikan në kërkim të drejtësisë për ato mijëra viktima", ka deklaruar Osmani. Në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Osmani konfirmoi se Kosova dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të qëndrojnë bashkë në luftimin e terroristët dhe luftimin e fenomeneve negative. Gjatë homazheve, kryetarja Osmani shoqërohej edhe nga nënkyetarët e Kuvendit, Arbërie Nagavci dhe Memli Krasniqi.

Hoti: Çdo sulm që bëhet ndaj botës demokratike është sulm ndaj popullit të Kosovës


Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në nderim të viktimateve të 11 shtatorit 2001,

Kosnetti: Partneriteti ShBA - Kosovë tejkalon raportet politike

Me rastin e 19-vjetorit të sulmeve terroristë të ShBA, ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, u shpreh se partneriteti ShBA - Kosovë tejkalon raportet politike. "Sot përkujtojmë jo vetëm ngjarjet e tmerrshme të 11 shtatorit 2001, por edhe lidhjen e ngushtë dhe partneritetin mes popullit të ShBA-së dhe Kosovës dhe ky partneritet tejkalon politikën. Për dy dekada, populli i ShBA-së dhe Kosovës qëndruan së

bashku për ta luftuar terroristët, në përpjekje për ta ndërtuar një të ardhme në paqe, drejtësi e përparim për njerëzit e të dy vendave tona dhe përfinqjet", ka thënë ambasadori Kosnett. Ai ka falenderuar popullin e Kosovës që çdo vit përkujton viktimat e sulmit të 11 shtatorit të vitit 2001, ndërsa ka shtuar se ShBA-ja dhe Kosova do ta forcën partneritetin për ta luftuar terroristët dhe fenomenet negative.

ndëruar të rënët dhe heronjtë që u dolën në ndihmë atë ditë të gjithë të rënëve në atë sulm terrorist, para 19 vjetëve. "Sulm i cili nuk ishte vetëm ndaj popullit amerikan, por ishte edhe ndaj popullit të Kosovës dhe ndaj gjithë botës demokratike. Çdo sulm që bëhet ndaj botës demokratike është sulm ndaj popullit të Kosovës. Ne sot bashkëndiejmë me familjet e këtyre të rënëve dhe ashtu siç tha ambasadori, ajo ditë ka hapur një kapitull të ri të botës së civilizuar, të botës demokratike për të qëndruar së bashku dhe për t'i bërë ballë çdo sulmi që mund të vijë, për të dalë më të fortë nga çfarëdo sulmi që i vjen botës demokratike", ka thënë kryeministri Hoti, duke shtuar se populli i Kosovës ndan vlerat e njëjtë me popullin amerikan.





FLET PËR "EPOKËN E RE" KRYETARI I SBASHK-UT, RRAHMAN JASHARAJ

JEMI GATI PËR FILLIMIN E MËSIMIT

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se janë bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e viti të ri shkollor, i cili do të nisë të hënën, më 14 shtator. Jasharaj në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re" ka thënë se gjendja në shkolla është më e mirë, duke pasur parasysh angazhimin e të gjithëve që procesi mësimor të fillojë pavarësisht pandemisë Covid-19. "Në një pjesë të madhe të institucioneve janë bërë vërtet përgatitje gjatë gjithë këtyre dy javëve", ka thënë ai, duke e vlerësuar lart edhe angazhimin e Ministrisë së Arsimit dhe të ministrit Likaj. Në këtë kontekst, Jasharaj ka thënë se SBAShK-u gjatë gjithë kohës do ta monitorojojë situatën në shkolla për ta parë zbatimin e masave anti-Covid. Ndërsa sa i përket cilësisë në arsim, Jasharaj ka thënë se duhet t'u kushtohet vëmendje investimeve teknologjike në shkolla

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Më 14 shtator fillon viti i ri shkollor 2020/2021, i cili do të nisë në dy fazë. Faza e parë është paraparë të fillojë më 14 shtator në institucionet parashkollore, klasat 1, 2, 3, 6, edhe klasat 10 në shkolla. Edhe klasa 4-5 do të

fillojë sipas skenarit A, mësim të kombinuar ose prani në shkollë. Ndërsa më 21 shtator do të fillojnë mësimin klasat 7, 8, 9, 11 dhe 12. Këto klasa do ta fillojnë mësimin më 21 shtator si mësim i kombinuar me prani dy ditë në shkollë dhe tri ditë mësim në distancë. Në lidhje me fillimin dhe përgatitjet për vitin e ri shkollor

2020/2021 në një intervistë përgazetën "Epoka e re" ka folur kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBAShK), Rrahman Jasharaj. Ai ka thënë se janë bërë pothuajse të gjitha përgatitjet për fillimin e viti të ri shkollor. Në këtë kontekst, Jasharaj ka deklaruar se janë të

kënaqur me bashkëpunimin që kanë pasur me Ministrinë e Arsimit dhe me ministrin Ramë Likaj. "Nga ajo që kemi parë gjatë vizitave me ministrin Likaj në disa shkolla dhe nga informacionet që kemi marrë nga kryetarët e nivelit komunal sindikal nga komunat e Kosovës, janë bërë përgatitje brenda mundësive dhe gjendja

tani është shumë më e mirë se ajo që ishte para fillimit që planifikohet më 1 shtator", është shprehur Jasharaj, duke shtuar se tashmë edhe mësimdhënësit janë të përgatitur për fillimin e mësimit.

Në këtë kontekst, Jasharaj ka thënë se SBAShK-u do ta monitorojojë procesin mësimor për shkak të situatës me pandeminë Covid-19. "Veprimtarë të SBAShK-ut nga afër do ta përcjellin situatën dhe krijimin e masave mbrojtëse në shkollat e tyre dhe do ta kemi një pasqyrë të quartë e të saktë që nga e hëna e 14 shtatorit", ka deklaruar Jashari, duke shtuar se, varësisht prej rrëthanave, mësimdhënësit do të testohen për Covid. Më tutje, Jasharaj ka folur për reformat dhe cilësinë në arsim. Ai ka thënë se në arsim janë

shkollor 2020/2021, fazës së parë. Sa janë të gatshme shkollat për fillimin e viti shkollor të hënën?

Jasharaj: Nga ajo që kemi parë gjatë vizitave me ministrin Likaj në disa nga shkollat dhe nga informacionet që kemi marrë nga kryetarët e nivelit komunal sindikal nga komunat e Kosovës janë bërë përgatitje brenda mundësive dhe gjendja tani është shumë më e mirë se ajo që ishte para fillimit që planifikohet më 1 shtator. SBASHK-u e ka thënë edhe në takime, por edhe publikisht, se ky angazhim duhet të vazhdojë dhe të angazhohen të gjitha palët brenda kompetencave dhe obligimeve që kanë marrë.

"Epoka e re": Si SBASHK, a mendoni se përgatitjet janë bërë në mënyrën më të duhur?

Jasharaj: Në një pjesë të madhe të institucioneve janë bërë vërtet përgatitje gjatë gjithë këtyre dy javëve. Mund të ketë edhe ndonjë institucion arsimor që nuk ka bërë përgatitje të duhura, por taskforcat e formuara në nivel shkolle dhe në nivel të drejtoreve arsimore do ta plotësojnë formularin gjegjës dhe do të deklarohen për shkollat, gjegjësisht për përgatitjet se sa janë bërë.

"Epoka e re": Çfarë do të thotë për mësimdhënësit ky proces mësimor në këtë kohë pandemie?

Jasharaj: Mësimdhënësit janë deklaruar qëmoti se janë të përgatitur dhe janë shprehur qysh në muajin gusht se janë për versionin e fillimit të vitit të ri në institucionet arsimore. Ata kanë ngritur çështjen e sigurisë dhe masave mbrojtëse për nxënësit dhe punëtorët arsimorë dhe ne e kemi aktualizuar këtë çështje në takimet në MASH-in, në takimet me DKA-të dhe të tjerët, por edhe në paraqitjet publike.

"Epoka e re": Sipas planit, secila shkollë ka task-forcën e vet dhe ajo do të vendosë për llojin e skenarit me të cilën zhvillohet mësimi në bazë të kapaciteteve të shkollës. A besoni se do të ketë sukses kjo mënyrë e fillimit të mësimit?

Jasharaj: Urojmë që të nisë mbarë viti i ri shkollor. Taskforcat kanë detyra konkrete, por edhe obligime dhe përgjegjësi dhe ata duhet t'i realizojnë detyrat e tyre. Po ashtu, edhe veprimitarë të SBASHK-ut nga afër do ta përcjellin situatën dhe krijimin e masave mbrojtëse në shkollat e tyre dhe do ta kemi një pasqyrë të qartë e të saktë që nga e hëna e 14 shtatorit.

"Epoka e re": Të premten keni mbajtur takimin e Kryesisë së Kolegjiumit për Arsim sa i përket përgatitjes për fillimin e viti shkollor?

Jasharaj: Ky proces është bërë

sipas vendimit të Institutit të Shëndetësisë Publik dhe ka qenë kërkesë e SBASHK-ut. Madje ne kishim kërkuar që të bëhet testimi i tërë personelit arsimor dhe i të punësuarve të tjerë në sistemin arsimor, por pasi që Institutit ka edhe angazhime shumë të mëdha me testimet e tjera në këtë situatë të rënduar nga Covid-19 vendim që si mostër të bëhet testimi i këtij numri të punëtorëve arsimorë dhe nga kjo mostër do të fitohet një pamje se si qëndrojnë punët. Besoj se do të vazhdohet edhe në të ardhmen me testimin e një numri tjetër të punëtorëve arsimorë sipas situatës aktuale që do të jetë.

"Epoka e re": SBASHK, a mendoni se përgatitjet janë bërë në mënyrën më të duhur?

Jasharaj: Në një pjesë të madhe të institucioneve janë bërë vërtet përgatitje gjatë gjithë këtyre dy javëve. Mund të ketë edhe ndonjë institucion arsimor që nuk ka bërë përgatitje të duhura, por taskforcat e formuara në nivel shkolle dhe në nivel të drejtoreve arsimore do ta plotësojnë formularin gjegjës dhe do të deklarohen për shkollat, gjegjësisht për përgatitjet se sa janë bërë.

Jasharaj: SBASHK-u është i

kënaqur me bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit. Ne kemi qenë gjithmonë të prirë për bashkëpunim korrekt në shërbim të arsimit dhe përzgjidhjen me dialog të kërkuesave të anëtarësës. Ministri Likaj me angazhimin dhe korrektesinë e tij ka krijuar një klimë të mirë të bashkëpunimit dhe vazhdimit jemi në një front të përbashkët të angazhimit në shërbim të arsimit. Besojmë se kështu edhe do të vazhdohet.

"Epoka e re": Z. Jashari, ju shpeshherë keni qenë kritik sa iu përket reformave në arsim. A i kanë dhënë rezultatet e duhura këto reforma dhe çfarë duhet të bëhet në këtë drejtim?

Jasharaj: Kam deklaruar shpesh se në vitet e pasluftës në arsimin e Kosovës janë bërë shumë eksperimente dhe janë marrë modele të zhvillimit të arsimit nga vende shumë të

zhvilluara. Duhet krijuar një platformë tonën për arsimin bazuar në kushtet tona. Institucionet e Kosovës duhet ta përkrahin shumë më tepër MASH-in dhe arsimin duke krijuar kushte të duhura të punës arsimore dhe edukative në institucionet arsimore. Ka kaluar koha e procesit mësimor me shkumësa e shpuza. Duhet investuar në arsim në mënyrë që shkollat tona të ecin në hap me zhvillimet e hovshme teknologjike. Duhet ruajtur figura e mësuesit e jo që kjo figurë të kritikohet publikisht e pa bazë. Duhet shtuar numrin e inspektorëve profesionalë, të cilët do të shkojnë në shkollat tona e do të përcjellin në klasë punën e mësimdhënësit dhe ta lavdërojnë për punën dhe përkushtimin, por edhe t'i tregojnë përlëshimet eventuale, për t'i dhënë kështu mundësi e këshilla përmirësim të vazhdueshmë.

Platforma e shoqërisë civile për dialog kërkon transparencë nga qeveria

PRISHTINË, 11 SHTATOR (ER) - Trembëdhjetë organizata të shoqërisë civile që kanë themeluar platformën për dialogun Kosovë-Serbi kanë bërë me dije se janë duke ndjekur me vëmendje zhvillimet në lidhje me procesin e dialogut. "Ne, anëtarët e shoqërisë civile, po i ndjekim me vëmendje zhvillimet në lidhje me procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përkundër kërkuesave të vazhdueshme për një rol të shtuar dhe përfshirje të ShBA-së në dialog, ne shprehim shqetësimin tonë përmungesën e transparencës që ka shoqëruar procesin e arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë në Uashington. Për më tepër mban ende të panjohur hapat

e ardhshëm drejt zbatimit të saj", theksohet në komunikatën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI).

Në këtë komunikatë theksohet se duke ndjekur praktikë të njëjtë, qeveria po vazhdon takimet në Bruksel, ku është paralajmëruar mundësia e arritjes së një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. "Sidoqoftë, përfaqësuesit e Kosovës nuk kanë ofruar detaje në lidhje me agjendën, temat dhe pozicionin e Kosovës në këto takime në Bruksel. Qeveria e vendit si bartëse e këtij procesi nuk ka qenë transparente as ndaj Kuvendit si organi më i lartë mbikëqyrës i politikës së jashtme. Raportimet e deritanishme të Qeverisë në Kuvend në

lidhje me dialogun kanë qenë vetëm sipërfaqësore, duke mos ofruar informacione konkrete për zhvillimet në kuadër të këtij procesi. Qeveria e Kosovës nuk ka ndarë me deputetët as platformën shtetërore për dialogun me Serbinë dhe nuk e ka bërë publik këtë dokument as për qytetarët. Mungesa e informacionit në lidhje me dialogun ka shkaktuar konfuzion dhe pasiguri te qytetarët për rezultatet e pritura të këtij procesi", është thënë në këtë komunikat.

'Platforma e Shoqërisë Civile për Dialog' kërkon që procesi i dialogut të zhvillohet mbi parime të mirëfillta të transparencës dhe llogaridhënie së Qeverisë para Kuvendit dhe publikut të gjërë.



Aliu: Përpjekjet për ta vënë në diskutim pronësinë e Liqenit të Ujmanit përbëjnë shkelje të Kushtetutës

Liqeni i Ujmanit është ndërtuar me forca vetjake të Kosovës. Ai i takon Republikës së Kosovës dhe përpjekjet për ta vënë në diskutim pronësinë mbi të përbëjnë shkelje të Kushtetutës në nenin 2, paragrafin 2, nenin 121 dhe atë 122 të saj. Kështu ka thënë të premten në një konferencë për media deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis, Liburn Aliut, ka mbajtur të premten konferencë për media, në të cilën ka folur lidhur me marrëveshjen e arritur në Shtëpinë e Bardhë në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht për Liqenin e Ujmanit. Ai ka thënë se Liqeni i Ujmanit është ndërtuar me forca vetjake të Kosovës dhe i takon Republikës

së Kosovës.

Aliu ka thënë se një ndër pikat më kritike në dokumentin e zotimeve të nënshkruar në Uashington nga Hoti është pika 7, pra ajo që ka të bëjë me ndarjen e Ujmanit me Serbinë. "Në atë dokument thuhet qartë se palët do të pajtohen që të bashkëpunojnë në studim të fizibilitetit për ndarjen e liqenit të Ujmanit. Pra, sipas këtij dokumenti, Liqeni i Ujmanit do të ndahet. Pra, Serbia do të jetë bashkëpronare apo thënë qartë, Serbia pranohet si hisenike në Ujman. Kjo pikë në dokumentin e nënshkruar, përbën hapje të një dere të madhe për Serbinë



në Kosovë. Derën që tash e sive Serbia synon ta hapë me presion, pra atë të qenit bashkëpronare dhe të diskutimit për secilën pronë në Kosovë. Këtë e arriti në Uashington me nënshkrim të palës së Kosovës", ka thënë deputeti i LV-së.

Aliu ka thënë se pranimi që të diskutohet për pronësinë mbi Ujman dhe pranimi që ai të ndahet me Serbinë është precedent i rrezikshëm që në thumb ka shkatërrimin e shtetit të Kosovës e që Serbia e synon dhe Hoti bashkë me

delegacionin e mundësoi këtë. "Kjo pikë e marrëveshjes është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, konkretisht me nenin 2, paragrafin 2 të Kushtetutës. Integriteti territorial dhe sovraniteti i Republikës së Kosovës, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, janë elemente themelore dhe të veçanta të ekzistimit të shtetit të Kosovës", është shprehur ai. Po ashtu, Aliu ka pohuar se kjo pikë shkel rëndë nenin 122 të Kushtetutës (Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve

Natyrore). "Pasuritë e Kosovës nuk mund të përvetësohen juridikisht, kontrollohen dhe menaxhohen nga një shtet tjetër, duke përfshirë edhe Ujmanin, duke ditur se këto resurse natyrore gjenden dhe janë me interes për Republikën e Kosovës. Gjithashtu, pika 7 e marrëveshjes është në kundërshtim edhe me nenin 121 të Kushtetutës, i cili nen rregullon pronën. Pra, asnjë paragraf i këtij neni nuk lejon që prona e Republikës së Kosovës të bartet juridikisht, në asnjë shtet tjetër me asnjë bazë juridike ndërkombëtare apo vendore, aq më pak të kontrollohet dhe menaxhohet nga shteti dhe pushteti serb", ka deklaruar ai.

Aliu ka thënë se kjo qeveri duhet të bjerë sa më parë. "Çdo ditë e më shumë e qëndrimit të saj është dëm për Kosovën dhe për këtë jam i bindur se janë të vetëdijshëm edhe subjektet e tjera politike që po qëndrojnë indiferente ndaj këtij fakti", ka thënë ai.

FSK-ja pranon donacion nga Gjermania në vlerë prej 500 mijë eurosh

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë të premten është mbajtur ceremonia e pranim-dorëzimit të donacionit me pajisje mjekësore nga Republika e Gjermanisë për FSK-në. Ky donacion kap vlerën e 500 mijë eurove. Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, paraprakisht ka pritur në zyrën e tij ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, të cilin fillojmisht e ka uruar për detyrën e re.

Më tutje, ai i ka shprehur mirënjojen e thellë përmbrështetjen e përhershme të Gjermanisë ndaj Kosovës.

Quni ka theksuar se edhe donacioni që kanë pranuar të premten është në vazhdën e ndihmës së madhe të Gjermanisë, Ministrisë së saj të Mbrojtjes dhe forcave gjermane për ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e FSK-së.

Ministri Quni ka vlerësuar lart edhe angazhimin e oficerëve dhe nënoficerëve gjermanë në kuadër të ekipit të NALT nën lidershipin e gjeneralit Best, i cili vazhdon traditën e paraardhësve të tjerë me profesionalizëm dhe efektivitet të lartë. "Gjermania si vend mik yni,

është një ndër partnerët tanë kryesor strategjik dhe se sukseset tonë të deritashme, bashkë me partnerët e tjerë, janë të arritura të përbashkëta", ka thënë Quni.

Ndërsa ambasadori Rohde ka rithkuar zotimin e Gjermanisë për vazhdimin e mbështetjes së FSK-së për t'i arritur objektivat e saj zhvillimore. Ai ka shprehur konfirmimin për shtimin dhe thellimin e mëtejshmë të bashkëpunimit bilateral.

Gjatë takimit, ministri Quni shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe drejtori i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integrimë Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha.

Pas takimit, ministri Quni dhe ambasadori Rohde kanë marrë pjesë në ceremoninë e pranim-dorëzimit të donacionit në vlerë prej 500 mijë eurove në Regjimentin e Mjekësisë, respektivisht Qendrën Mjekësore të FSK-së.

Gjatë ceremonisë gjenerallejtënant Rrahman Rama ka falenderuar ambasadorin Rohde dhe stafin ushtarak gjerman për angazhimin e tyre të madh për këtë donacion dhe të gjitha donacionet dhe kontributet e tyre të deritashme përgjithës. Kurse ambasadori Rohde ka thënë:



"Është kënaqësi e veçantë që sot, gjatë vizitës sime të parë në Ministrinë e Mbrojtjes, në emër të qeverisë gjermane, kam rastin të dorëzoj një donacion të madh me pajisje mjekësore. Ky donacion do t'i mundësojë Shërbimit Mjekësor të FSK-së për ta ngritur gatishmërinë e FSK-së në mënyrë që ajo ta arrinë të ashtuquajturin kapacitet të 'Roli 1' të NATO-s. Realizimi i këtij donacioni ka qenë një bashkëpunim gjermano-koso-

var në mes të këshilltarëve gjermanë dhe ekspertëve mjekësor të FSK-së".

Në fund të kësaj ceremonie, ministri Quni ka shprehur rëndësinë që kanë këto pajisje përfshirë të reagim dhe trajtim të ndërsjellë në operacione dhe shpëtim të jetëve të qytetarëve. "Për çdo jetë të shpëtuar do të jemi krenarë së bashku", ka thënë Quni.

Të pranishëm në këtë ceremoni kanë qenë edhe zyrtarë dhe oficerë nga ambasada dhe forcat gjermane si dhe nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Donacioni në fjalë është në vazhdën e mbështetjes permanente të qeverisë dhe forcave gjermane për kompletimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Regjimentit të Mjekësisë së FSK-së dhe shërbimit mjekësor të saj në të gjitha nivelet.

Raporti 24-orësh i IKShPK-së për Covid: Pesë të vdekur, 117 të shëruar dhe 50 raste të reja

Pesë të vdekur dhe 50 raste të reja me Covid

Ditët e fundit në Kosovë është shënuar rënie e lehtë e rasteve të reja me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 50 raste të reja me Covid-19 dhe janë shëruar 117 persona. Krahas rasteve të reja, IKShPK-ja ka njoftuar se pesë persona e kanë humbur betejën nga Covid-19, duke e çuar në 586 numrin e përgjithshëm të vdekjeve. Sipas IKShPK-së, në Kosovë janë edhe 2 760 raste aktive me virusin "Korona".

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur pesë persona si pasojë e infekzionit me Covid-19. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe janë shëruar 117 persona dhe janë paraqitur 50 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 561 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 50 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 5 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 14 496 raste nga 56 606 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 586 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 117

pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 1 150 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 760", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar rastet e reja sipas komunave në nivel vendi. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 6 raste, komuna Gjilan 5 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Kamenicë 4 raste, komuna Pejë 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Podujevë 3 raste, komuna Rahovec 3 raste, komuna Shtime 3 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Gjakovë, Kaçanik, Lipjan, Novobërdë dhe Skenderaj", ka njoftuar IKShPK-ja.

Zemaj thotë se falë përkushtimit ka rënë numri i rasteve të reja me Covid

Në lidhje me rënien e rasteve të reja me Covid, ka reaguar ministri i Shëndetësisë, Armend



AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

Zemaj. Ai ka thënë se falë përkushtimit të gjitha institucioneve, Kosova qëndron më mirë sa i përket menaxhimit të pandemisë. "Me përkushtimin dhe angazhimin maksimal ka rënë trendit të infektuarve, ku sot nga 561 të testuar, raste pozitive janë 50. Jemi më mirë se shumë vende të tjera në rajon, madje edhe më mirë se vendet me sistem më të avancuar shëndetësor, e kjo na bën edhe më të përkushtuar e të vendosur që ta ngrehim performancën e shëndetësisë tonë", ka thënë Zemaj, duke bërë bilancin e 100-ditëshit si ministër i Shëndetësisë. "Sot, kur po i bëj

100 ditë në krye të Ministrisë së Shëndetësisë, dua t'ju falënderoj përzemërsisht përbashkëpunimin që kemi pasur gjatë këtyre ditëve, me të gjitha institucionet për respektimin e masave sa i përket mbrojtjes nga Covid-19. Kam vizituar shumë qytete dhe fshatra, kam takuar shumë qytetarë, kemi folur e kemi ballafaquar argumente për dhe kundër pranisë dhe luftimin e virusit Covid-19 në mesin tonë. Nga të gjitha takimet me juve, në tërë vendin, rrjedh një përfundim i padiskutueshmë se të bashkuar ia dalim", është shprehur Zemaj. Më tutje, Zemaj ka ftuar edhe qytetarët të janë të bashkuar përmposhtjen e virusit "Korona".

"Do të jem unë me tërë ekipin tim në shërbimin tuaj në pajtim me mandatin ligjor, duke ju siguruar dhe do të bëj gjithçka që ta ulim numrin e të prekurve me Covid-19, të infektuarve t'ju qëndrojmë afér si dhe të gjithë së bashku të kujdesemi për shëndetin e të gjithëve. Të nderas qytetarë, përzemërsisht ju ftoj që edhe më tej të jeni bashkëpunuesit tonë, sepse vetëm të bashkuar, mund të arrimjë aty ku dëshirojmë, ta largojmë pandeminë!", ka thënë Zemaj, duke ftuar qytetarët që ta mbajnë distancën, bartin maskën dhe mbajnë pastërtinë.

Ndërron jetë gazetari Sulejman Gashi

PRISHTINË, 11 SHTATOR (ER) - Ka ndërruar jetë gazetari Sulejman Gashi, i cili ka punuar si korrespondent i RTK-së në ShBA. Lajmin e ka bërë me dije djali i Sulejman Gashit, Dritoni, nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook". "Me pikëllim të thellë ju njoftojmë që sot, më 11 shtator 2020, ndërroi jetë më i dashuri ynë z. Sulejman Gashi. Ai po luftonte shumë që të rikthehej nga gjendja e rëndë që kishte pësuar katër vjet më parë. Varrimi i të ndjerit do të bëhet në vendlindjen e tij në Kosovë, vendin të cilin ai e deshi aq shumë. Sulejman Gashi bëri një jetë, dhe la një vepër, me domethëniet të jashtëzakonshme për familjen, profesionin, vendin dhe kombin e tij", ka shkruar Driton Gashi.

Për vdekjen e gazetarit Gashi ka reaguar Asociacioni i

Gazetarëve të Kosovës (AGK). "Gashi ishte korrespondent i Radiotelevizionit të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku nga atje raportoi përluftën në Kosovë si dhe përtë gjitha zhvillimet nëpër të cilat kaloi shteti i Kosovës. Përveç profesionit të gazetarit, ai ishte edhe një aktivist i shquar në forcimin e marrëdhënieve Kosovë-ShBA. Vdekja e Sulejman Gashit është një humbje e madhe përkundrejtësore, andaj me pikëllim të thellë AGK-i shpreh ngushëllime familjarëve, miqve dhe kolegëve të gazetarit Sulejman Gashi", është thënë në reagimin e AGK-së.

Sulejman Gashi kishte pësuar një arrest kardiak në vitin 2016 përderisa ishte në një udhëtim pune dhe që nga ajo kohë ai ishte përballur me probleme shëndetësore.



Çmimet e konsumit shënuan rritje në muajin gusht

EPOKA ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin gusht 2020, viti bazë 2015=100. Inflacioni më i madhi nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.1 për qind në muajin gusht 2020.

Indeksi i tertireshëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0.1 për qind në muajin gusht 2020, krahasuar me muajin korrik 2020. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nengrupet e COICOP-it: ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (0.5 për qind); mallra dhe shërbime përmirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (1.6 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (2.5 për qind)-(ngritje e çmimeve të naftës dhe benzinës), me një ndikim të përbashkët të këtyre nengrupeve

prej 0.2 për qind në IHÇK. Ndërsa sa i përket rënies së çmimeve, vërehet te nengrupet e COICOP-it: pemë (-2.5 për qind); perime (-1.8 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nengrupeve prej (-0.1) për qind në IHÇK. "Norma vjetore e inflacionit e matur në muajin gusht 2020 me muajin gusht 2019 ishte (-0.5 për qind). Indeksi i tertireshëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënien në një mesatare prej (-0.5 për qind) në muajin gusht 2020, krahasuar me muajin gusht 2019. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nengrupet e COICOP-it: qumësht, djathë dhe vezë (-3.2 për qind); perime (-3.7 për qind); pije alkoolike (-1.2 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-1.1 për qind)-(rënje e çmimeve të drunjve përmirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (1.6 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (-14.0 për qind)-(rënje e çmimeve të naftës dhe benzinës), me një ndikim të përbashkët të këtyre nengrupeve



vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (-1.4 për qind); pushime të organizuara (-5.6 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nengrupeve prej (-1.6 për qind) në IHÇK", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas ASK-së, ngritje e çmimeve vërehet te nengrupet e COICOP-

it: bukë dhe drithëra (2.6 për qind); mish (1.0 për qind); pemë (3.9 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe çembëlsira (4.1 për qind); kafe, çaj dhe kakao (2.1 për qind); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (1.7 për qind); duhan (2.2 për qind); produkte mjekësore aparaturë dhe pajisje

(4.8 për qind); shërbime ambulatore (5.5 për qind); blerje e automjeteve (0.8 për qind); shërbime hoteliere (2.4 për qind); sigurime (19.7 për qind) - (ngritje e çmimeve të sigurimeve të automjeteve), me një ndikim të përbashkët të këtyre nengrupeve prej 1.1 për qind në IHÇK.

470 biznese të reja u regjistruan vetëm gjatë këtij viti në Ferizaj



FERIZAJ, 11 SHTATOR (ER) - "Ferizaj, kryeqendra e zhvillimit ekonomik, edhe këtë vit regjistroi një statistikë pozitive në të bërit biznes falë edhe kushteve të infrastrukturës së krijuar nga institucionet komunale për zhvillimin e bizneseve dhe eliminimin e burokracive për regjistrimin e bizneseve", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Ferizajt. Vetëm këtë periudhë të vitit 2020 nga Zyra e Regjistrimit të Bizneseve në kuadër të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik raportohet për regjistrimin e 470 të reja në Komunën e Ferizajt. Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Zekir Bytyqi, tha se me përmirësimin e kushteve nga qeverisja lokale e udhëhequr nga kryetari i Komunës, Agim Aliu, orientimin

në investime të digitalizimit të shërbimit si dhe hapjes së Zyrës së Zhvillimit Ekonomik, të gjithë të interesuarit për hapjen e bizneseve, i ofrohen lehtësira për regjistrimin e bizneseve si dhe gjithë pakon tjetër mbështetëse nga zyrtarët kompetentë të fushës. "Numri prej 470 bizneseve të reja të regjistruara vetëm gjatë kësaj periudhe kohore në Ferizaj është tregues pozitiv për ritmin e zhvillimit ekonomik lokal, aq më tepër kur kemi parasysh se ky vit është sfidues, determinuar nga gjendja epidemiologjike në vend. Madje ditëve në vijim, për ta shtuar këtë mbështetje, Komuna e Ferizajt do të vazhdojë me skemat mbështetëse për ndihmë konkrete të bizneseve, përmes pajisjeve dhe materialeve të punës", theksohen në njoftimin e komunës.

Ministri Krasniqi ftesë publike institucioneve, të furnizohen me prodhime vendore

PRISHTINË, 11 SHTATOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, nëpërmjet një ftesë publike, ka kërkuar nga institucionet publike të vendit duhet të kenë përgjegjësi morale dhe ligjore që gjatë furnizimeve me prodhime të ndryshme, të cilat prodhohen në vendin tonë, t'u jepet përparësi, me ndonjë kriter të veçantë, në suaza ligjore, gjatë

procedurat e tenderimit ta fusin si kriter prodhimin vendor. "Konsideroj se institucionet publike të vendit duhet të kenë përgjegjësi morale dhe ligjore që gjatë furnizimeve me prodhime të ndryshme, të cilat prodhohen në vendin tonë, t'u jepet përparësi, me ndonjë kriter të veçantë, në suaza ligjore, gjatë



AKK-ja heton sektorin e shëndetësisë, të sigurimeve dhe të ndërtimtarisë



Kryetari i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës (AKK), Valon Prestreshi, kanë thënë se nuk ka vend për shqetësimë sa iu përket çmimeve për testet serologjike për Covid-19 në laboratorët private. Po ashtu, në konferencën e thirrur nga AKK-ja është bërë me dije se ky institucion ka hetuar edhe sektorin e sigurimeve dhe të ndërtimtarisë

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës (AKK), Valon Prestreshi, kanë thënë të premten në një konferencë për media se nuk ka vend për shqetësimë sa iu përket

çmimeve për testet serologjike për Covid-19 në laboratorët privatë. Sipas tij, nuk ekziston më shërbimi me shumën prej 200 eurosh. "Vetëm katër teste janë lëshuar me 200 euro dhe nuk ka hapësirë që autoriteti ta ndëshkojë institucionin privat pasi tashmë ka ndërpërë këtë shërbim", ka deklaruar

Prestreshi, duke folur për sektorin e sigurimeve. "Autoriteti ka hetuar edhe sektorin e sigurimeve. Nga analizat e bëra konstatohet se kemi të bëjmë me një treg të rregulluar ku çmimet e produktit janë unifikuar. Kjo i bie se mungon presioni i konkurrencës ndërmjet

kompanive. Për këtë arsy, ne sërisht i bëjmë thirrje BQK-së si rregullatore e këtij tregu që ta marrë parasysh rekomandimin tonë të vitit 2019. Rekomandim ky që thekson se unifikimi i çmimeve të Primit të TPL është në kundërshtim me parimet e konkurrencës në një treg të lirë", ka thënë Prestreshi. Në këtë konferencë për media, temë diskutimi ishte edhe çmimi i cimentos. Pas shqetësimëve të ngritura nga ndërtimtarët për rritjen e çmimit të cimentos 20 për qind, nënkyetari i AKK-së, Ahmet

Krasniqi, ka theksuar se janë ende duke mbledhur informata dhe së shpejtë do të nxirret një vendim meritot për prodhuesin e cimentos. Ndërsa sa iu përket tenderëve të Ministrisë së Shëndetësisë të nënshkruar në pandemi, Fatime Haziri nga AKK-ja ka thënë se Autoriteti ka monitoruar tenderët e nënshkruar gjatë pandemisë në Ministrinë e Shëndetësisë. Megjithëse, sipas saj, autoriteti ka vodusur për të ndjekur pista më të avancuara për tenderët e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë.

Arifi mban takim online me ministrin e Bujqësisë, diskutohet për mbështetjen e fermerëve

PRISHTINË, 11 SHTATOR (ER) - Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Naim Arifi, ka mbajtur një takim online me ministrin e Bujqësisë, Besian Mustafa, kryetarët e komunave dhe drejtoret e DBPZhR-së. Gjatë këtij takimi u diskutua përfundit dëmeve që po ballafaqohen fermerët e të gjitha komunave gjatë periudhës së pandemisë.

Drejtori i DBPZhR-së, Naim Arifi, ka falënderuar ministrin Besian Mustafa, për mbështetjen e vazhdueshme ndaj fermerëve dhe komunave. "Sot, së bashku me kryetarët e komunave dhe drejtoret e bujqësisë, kemi mbajtur një takim online me ministrin e Bujqësisë, Besian Mustafa, me të cilët biseduan përfundit dëmeve që po ballafaqohen fermerët në këtë kohë pandemie. Falënderova ministrin Mustafa për bashkëpunimin e vazhdueshëm me komunat. I jam mirënjoyës përgjatë gjithë kësaj kohe", u shpreh ai.



Gjithashtu, drejtori Arifi ia ka drejtuar edhe disa kërkesa ministrit. "Kërkesat tonë për Ministrinë e Bujqësisë janë: Kërkova nga ministri që të hapen tregjet për shitjen e kafshëve, të

bëhet sa më shpejt kompensimi i dëmeve nga breshëri, një çështje tjeter që është kërkesë e fermerëve dhe drejtore, është që të mos vonohen pagesat direkte për subvencione përfundit, të bëhet vlerësimi si dhe shpallja e rezultateve përfundit të aplikacionet e dorëzuara në fazën e parë për grante 2020. Po ashtu, kërkova që të hapet sa më shpejt thirrja përfundit, përfundit,

masat 101 - sektori i qumështit nga lopët qumështore, deleve dhe dhittë. Sektori i majmërisë së viçave, sektori i pemëve manore, sektori i vezëve dhe zhvillimit të turizmit", ka shtuar Arifi.

Meral Sadriu-Vokshi emërohet drejtoreshë për Buxhet dhe Financa në Gjilan

GJILAN, 11 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka njoftuar të premtën se ka emëruar Meral Sadriu-Vokshi, drejtoreshë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa. Sadriu-Vokshi është e diplomuar në shkencat e ekonomisë dhe ka një përvojë pune në këtë lëmë, konkretisht në sektorin privat. "Në bazë të vendimit, prej datës 14 shtator 2020, emërohet në detyrën e Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa, Meral Sadriu-Vokshi. Ajo ka qenë e angazhuar në sektorin privat dhe është e dëshmuar në lëmin e ekonomisë. Drejtoresha do ta zëvendësojë drejtorin, tashmë

të ndjerë, Zijadin Maliqi, i cili është ndarë ngajeta javë më parë", ka thënë Haziri, duke shtuar se janë duke bërë riorganizimin dhe ristrukturimin e bordit të drejtoreve dhe stafit të brendshëm. "Nënkryetari Arbëri Ismajli është duke bërë vlerësimet në disa sektorë, gjithashtu edhe drejtoret janë autorizuar dhe po punojnë në vlerësimet brenda përgjegjësisë që kanë deri në funksionalizimin e plotë. Do të vazhdohet kështu me qëllimin e vetëm, ngritjen e nivelit të detyrës dhe punës deri në maksimum, për shërbim të denjë ndaj qytetarëve", ka përfunduar kryetari Haziri.



Komuna e Drenasit përkujdeset për hapësirat publike



DRENAS, 11 SHTATOR (ER) - Komuna e Drenasit ka njoftuar se në vazhdimësi është duke ndërmarrë aktivitete që kanë të bëjnë me pastërtinë e hapësirave publike dhe mirëmbajtjen e tyre. Drejtoria

për Shërbime Publike dhe Emergjencë në këtë komunë është duke mbikëqyrur mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike, në mënyrë që "mjedisi ku ne jetojmë të jetë i pastër, sidomos tani kur po

përballemi me pandeminë e shkaktuar nga virusi Covid-19". "Kujdesi ndaj mjedisit ndikon në ruajtjen e shëndetit të familjes dhe shoqërisë sonë", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

Së shpejti rehabilitohet rruga në Shipashnicë të Epërme të Kamenicës

KAMENICË, 11 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka bërë me dije se së shpejti do të fillojë sanimi i gjendjes së rrugës në fshatin Shipashnicë e Epërme, e cila kishte mbetur pa u rregulluar për shkak të moskryerjes së punës nga kompania e kontraktuar. Me këtë rast, Kastrati ka falënderuar banorët e këtij fshati për

bashkëpunimin. "Kjo rrugë në fshatin Shipashnicë e Epërme përreth dhjetë vjet ka mbetur e tillë si rezultat i moskryerjes së punës nga kompania e kontraktuar më parë. Me të marrë shqetësimin e banorëve kemi dalë në terren dhe shumë shpejt do të nisë sanimi i gjendjes në këtë rrugë. Faleminderit banorëve për bashkëpunimin!", ka thënë Kastrati.



Komuna e Mitrovicës suspendon nga puna mësimdhënësin që sulmoi bashkëshorten

MITROVICË, 11 SHTATOR (ER) - Komuna e Mitrovicës ka bërë me dije se pas marrjes së njoftimit zyrtar nga Policia e Kosovës lidhur me rastin e sulmit të mësimdhënësit (F. R.) ndaj bashkëshortes së tij (Q. R.), njëkohësisht të dy mësimdhënës në këtë komunë, kryetari Agim Bahtiri, në koordinim me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, Egzon Jashari, kanë marrë vendim për suspendim nga marrëdhënia e punës të të dyshuarit (F. R.) për aktin e kryer. Bahtiri ka theksuar se rasti i

ndodhur ka qenë mjaft shqetësues për qytetarët e Mitrovicës, me theks të veçantë edhe për kryetarin Bahtiri, i cili e ka vlerësuar si një akt shumë të ulët dhe jo njerëzor. "Çdo akt i dhunshëm duhet të trajtohet urgjentisht nga organet e rendit dhe ligjit, si dhe personave të tillë t'u shqiptohet dënimimi i merituar. Ne nuk do të lejojmë asnjëherë që mësimdhënësit të cilët shprehin dhunë të jenë pjesë e institucioneve arsimore në komunën tonë", ka thënë kryetari Bahtiri.



Kur analfabetët dhe të korruptuarit e udhëzojnë Dritan Abazoviqin



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Në Mal të Zi ndodhi një kthesë dhe një shkëputje e lehtë për fillim nga e kaluara që dominohej nga Millo Gjukanoviq. Millo Gjukanoviq në historinë e Malit të Zi e ka një vend që kurrë dhe askush nuk do të mund ta kundërshtojë; u shkëput nga kthetrat e Slloboden Milosheviqit duke e jetësuar pavarësinë e Malit të Zi e pastaj e njohu edhe pavarësinë e Kosovës që ishte një rrezik i madh politik dhe jo vetëm politik për Gjukanoviqin. E zgjodhi rrugën dhe përcaktimin evropian sikur që u largua nga ndikimi rus e që nxiti zemërimin e qarqeve shoviniste serbe në Beograd dhe Mal të Zi të cilët e vunë në veprim kishën ortodokse të Serbisë për të rrënuar themelat e shtetësisë së Malit të Zi përmes protestave proserbe. Nuk e pranuan të vërtetën se Mali i Zi ishte shtet edhe para se Serbia të bëhej shtet sikur që edhe kisha ortodokse e Malit të Zi ishte autoqefale para asaj serbe. Mali i Zi u bë anëtar i NATO-s e që e prishi imazhin se domosdoshmërisht duhet të jetë kundër NATO-s, pasi Serbia është e tillë.

Në referendumin për shpallje të pavarësisë, Malit të Zi i vendosën kushte që nuk vlenin për asnjë shtet tjetër me shpresë se nuk do të siguroheshin 53 për qind të votave të nevojshme. Votat e shqiptarëve, boshnjakëve, kroatëve dhe pakicave të tjera e bën Malin e Zi të pavarur dhe mendoj se shqiptarët nuk janë trajtuar me respekt në përputhje me rolin thuaja vendosës për pavarësinë e Malit të Zi. Pas një konference të organizuar në Podgoricë për të drejtat e pakicave, Baca Adem Demaci dhe unë patëm një takim me disa udhëheqës shqiptarë që përkrahjen për Millo Gjukanoviqin e kushtëzonin me disa kërkesa

politike të dorës së dytë krasuar me rëndësinë dhe peshën e referendumit.

Baca Adem Demaci ishte shumë i drejtpërdrejtë duke kërkuar nga ata që ta përkrahin pa asnjë kusht Gjukanin në mënyrë që të ndahet nga ish-Jugosllavia e mbetur e që pas pavarësisë të Malit të Zi, të kërkjnë të drejtat kombëtare, qytetare dhe politike në kuadër të pavarësisë ku Slloba dhe Serbia nuk do të kishin ndikim. U bë pavarësia, me njëqindmijë probleme dhe Gjukanoviqi, pas një shkëputjeje nga një diktaturë dhe autokraci, ngadalë filloj të mbështillet me petkun e autokratit sikur Tuxhmani në Kroaci, më parë. Deshëm apo nuk deshëm ta pranojmë qëndrimi mbi 30 vjet në pushtet, t'i nxjerrë brirët e një autokrati pavarësish qëllimit që e keni e që mbështetet me interesat e qytetarëve shqiptarë që iu kërkonte votën por në saje që ua mbante zhagun fituesve të zgjedhjeve prandaj jetëgjatësinë politike e kishin të kushtëzuar me të atyre që ishin në pushtet. Për këtë arsy kemi liderë dhe politikanë shqiptarë në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës që gjithmonë kanë qenë në shalën e pushtetit, pa zbritur asnjëherë nga ajo. Edhe në zgjedhjet e fundit në Mal të Zi, liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë "votuan" qartë për Gjukanoviqin duke krijuar një situatë se, nëse ndodhë e kundërtë, e pati Kosova, Shqipëria dhe krejt shqiptaria. Pas zgjedhjeve kur doli se Dritan Abazoviqi do të jetë përcaktues për formimin e qeverisë, me apo pa Gjukanoviqin, e donin që me çdo kusht të jetë me Millon, filluan vardisjet, glorifikimi, kërcënimi dhe shantazhimi i Dritanit në mënyrë që më asnjë mënyrë të mos bëjë koalicion me partitë serbe dhe ruse shkaku se po rezikohet njohja e Kosovës nga Mali i Zi, po mundësohet kthimi i Serbisë dhe Rusisë në Mal të Zi dhe se po rezikohet seriozisht siguria në rajon dhe ajo globale. I dërguan letra të hapura dhe të mbyllura, ia kontestuan përkatësinë kombëtare, ia kujtuan se sa fort i ka fyer ndjenjat kombëtare dhe patriotike të shqiptarëve për Skënderbeun dha familjen e tij duke i lënë mundësinë të

Dritani: Shqipëria, në vend se të bëhet Piemont i bashkimit të shqiptarëve, kudo që jetojnë, përmes liderëve kanë luajtur rolin përqarë duke ndarë në parti që i përkrahi dëshira të tjerë. Edhe në Kosovë, politikanët e Kosovës, që nga Rugova dhe të tjerët në vazhdimësi kanë përqarë shqiptarët në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës duke e leopardizuar elektoratin në ata që janë me ne dhe kundër nesh. Udhëheqësit e shqiptarëve nga këto troje vinin në Prishtinë ku mbusheshin me negativitet pas së cilës, në vend se të mobilizoheshin për interes të votuesve të tyre, ata luftonin, deri në armiqësi njëri - tjetrin prandaj faktori shqiptar defaktorizohej deri në marginalizim. Kjo situatë prodhoi një klasë politike që mbijetonte, jo shkaku se punonte për interesin e qytetarëve shqiptarë që iu kërkonte votën por në saje që ua mbante zhagun fituesve të zgjedhjeve prandaj jetëgjatësinë politike e kishin të kushtëzuar me të atyre që ishin në pushtet. Për këtë arsy kemi liderë dhe politikanë shqiptarë në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës që gjithmonë kanë qenë në shalën e pushtetit, pa zbritur asnjëherë nga ajo. Edhe në zgjedhjet e fundit në Mal të Zi, liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë "votuan" qartë për Gjukanoviqin duke krijuar një situatë se, nëse ndodhë e kundërtë, e pati Kosova, Shqipëria dhe krejt shqiptaria. Pas zgjedhjeve kur doli se Dritan Abazoviqi do të jetë përcaktues për formimin e qeverisë, me apo pa Gjukanoviqin, e donin që me çdo kusht të jetë me Millon, filluan vardisjet, glorifikimi, kërcënimi dhe shantazhimi i Dritanit në mënyrë që më asnjë mënyrë të mos bëjë koalicion me partitë serbe dhe ruse shkaku se po rezikohet njohja e Kosovës nga Mali i Zi, po mundësohet kthimi i Serbisë dhe Rusisë në Mal të Zi dhe se po rezikohet seriozisht siguria në rajon dhe ajo globale. I dërguan letra të hapura dhe të mbyllura, ia kontestuan përkatësinë kombëtare, ia kujtuan se sa fort i ka fyer ndjenjat kombëtare dhe patriotike të shqiptarëve për Skënderbeun dha familjen e tij duke i lënë mundësinë të

rehabilitohet përmes distancimit me partitë serbe dhe bashkimin me Gjukanoviqin në kohën kur Dritan Abazoviqi shpalosi parime të qarta sikur lufta kundër korruptionit, krimit të organizuar, orientimit evropian, anëtarësimit të NATO-s, respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, respektimit të njohjes së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran, sikur edhe respektimit të identitetit të shtetit të Malit të Zi në të gjitha aspektet sikur edhe zotimi se nuk do të ketë hakmarrije ndaj askujt. Mbi këto premtimet dhe parime i ka fituar votat prandaj është e pamoralshme, e pandershme dhe e palejueshme që të bëhet presion ndaj Dritanit, jo se e bëjnë këtë pse u ha prapanica për Malin e Zi por se e bëjnë për të ruajtur postet dhe pasurinë të fituara me korruption dhe krim të organizuar ndaj të cilave, në Mal të Zi duket të jetë i pakompromis prandaj, në këtë drejtim e përkrahu dhe i uroj shumë sukses. Nëse këto parime dhe premtimet nuk i ka të sinqerta, përgjigjen e merr menjëherë nga votuesi në Mal të Zi. Diçka është shumë e vërtetë dhe e sigurt, Dritan Abazoviqin e kanë sulmuar pikërisht ata që korruptionin dhe krimin e organizuar e kanë shndërruar në mënyrë të jetesës dhe mbijetesës e të cilët nuk kanë të bëjnë asnjë me njëheroren, kombëtaren, moralen e lëre më me shtetin e së drejtës. Dritanin e kanë "këshilluar" dhe po e këshillojnë ata që i kanë shërbyer çdo regjimi dhe çdo pushtuesi, që kanë lehur dhe që e kanë kafshuar deri në vdekje çdo patriot, hajnat dhe kriminelët e certifikuar që e kanë dhunuar dhe po e dhunojnë vet shtetin dhe ardhmërinë dhe përfituesit e luftës, pa e shkrepur as edhe një plumb të faktorizuar dhe të shndërruar në politikanë të merituar dhe duke marginilizuar patriotët dhe sakrifikuësit e vërtetë! Prandaj Dritan, nëse kthen kokën pas çdo qeni që lehë, siç thoshte Dostojevski, asnjëherë nuk do të mbërrish në cak. Mua nuk mund të më zhgënjes por mund të zhgënjes votuesit tuaj dhe të gjithë ata që nuk e kanë humbur shpresën për një ardhmëri më të mirë për të gjithë.

E jashtëzakonshme

“Qentë robotë” bëhen pjesë e ushtrisë amerikane



Nga një avion dalin, përveç ushtarëve, edhe miqtë e tyre me katër këmbë. Nuk janë qen, por robotë ose mjetet e luftës së të ardhmes. Miqtë “eri” më të mirë të njeriut, krijuar nga kompania

amerikane “Ghost Robotics” morën pjesë në një stërvitje të ushtrisë javën e kaluar, për t'i parë kapacitetet e tyre dhe mënyrën sesi mund të përshtaten në betejë. Qentë robotë janë vetëm një pjesë e asaj që

ushtria amerikane Sistem i Avancuar i Menaxhimit të Betejës, ku inteligjenca artificiale përdoret për të analizuar dhe pikasur kërcënimet që i kanosen ushtrisë amerikane.

FOTO E DITES



Pamje nga punimet e unazës së madhe në Tiranë

BARSOLETA E DITËS



Dy kamionistë udhëtojnë me kamion në një rrugë me mjegull, në një çast ai që është në timon zgjon atë tjetrin që po flinte dhe i thotë:
 - Mos vallë këtej ka pinguinë?
 - Jo, i thotë ky. Qysh këtu të ketë pinguinë?!
 - Ta hajë dreqi, e paskemi shtypur një murgeshë atëherë!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E rrallë

Blen shtëpi me çmim të ulët, befasohet çfarë kishte në oborr

Kur 35-vjeçari John Reynolds nga Teksasi bleu një shtëpi me tri dhoma gjumi në qytetin e vogël të Mineral Wells përvetëm 20 000 dollarë, ai nuk kishte ide se çfarë do të gjente në oborrin e saj. Ai planifikoi ta rinovente dhe shiste shtëpinë në mënyrë që të fitonte para, pastaj zbuloi një pishinë të madhe

noti në oborr nën bar dhe gjetje. John, i cili normalisht punon si teknik mjekësor, u ndje sikur kishte fituar lotarinë dhe as nuk donte ta shiste shtëpinë më. “Unë u ndjeva sikur rastësisht hasa në një biletë lotarie. Unë kurrë në një milion vjet nuk mendova se do të bljija një pronë që do të kishte një pishinë”, tha ai.



DASHI
Ditën e sotme me siguri do të përplaseni me një ose më shumë anëtarë të familjes, ndoshta për çështje që lidhen me paratë.



DEMI
Nga një kënd-vështrim profesional, ju thjesht duhet të arrini dhe të grumbulloni atë që dëshironi.



BINJAKËT
Edhe nëse do t'ju kushtojë, mermi parasysh me kujdes shpenzimet dhe të ardhurat tuaja në mënyrë që të mos keni ndonjë surprizë më vonë.



GAFORRJA
Sot do të zbuloni se një qëndrueshëm do t'ju japë më shumë besueshmëri te tjerët.



LUANI
Dicka pozitive do të ndodhë në angazhimet tuaja, të cilat janë gjithnjë e më të ngutshme dhe të shumta.



VIRGJËRESHA
Mendja juaj do të jetë vigilente dhe do të vini re detaje të rendësishme që keni humbur deri më tanë.



PESHORJA
Projektet dhe synimet kthehen në një drejtim, por vendimet dhe vullneti i të tjerëve ndërhyjnë për t'i ndryshuar kartat në tryezë.



AKREPI
Kënaqësitë dhe sukseset do të bien mbi ju, pa bërë shumë sakrifica. As sektori sentimental nuk është i keq.



SHIGJETARI
Ju mund të lidhni mënyrështë të mira, t'i rikuperoni kreditë, të planifikoni udhëtime biznesi.



BRICJAPI
Kur bëhet fjala përpunën, maturia nuk do të jetë kurrë shumë dhe do të dëshironi të keni më shumë se zakonisht në këtë ditë.



UJORI
Është koha përvendorur rregull rrith jush dhe përtë zgjidhur disa çështje praktike, të cilat përfis disa kohë kanë qenë një arsy përdiskutim me partnerin dhe familjen tuaj.



PESHQIT
Ju keni një frysë të jashtëzakonshme iniciative në anën tuaj, aq sa puna do të marrë një rendësi të veçantë.

Janë apo jo në lidhje? Dafina i bën befasinë e veçantë DJ Geek për ditëlindje



Dafina Zeqiri dhe DJ Geek janë komentuar shumë për lidhjen e tyre të dashurisë, të cilën tash e një kohë kanë deklaruar se e kanë përfunduar. Por, pavarësisht prej deklaratave të tyre, dyshen i shohim pothuajse kudo bashkë, duke nxitur dyshimet se ata nuk janë


ndarë asnijëherë. Megjithatë, Dafina nuk hezitoi që ta urojë publikisht DJ Geek me rastin e ditëlindjes, duke e kënduar atë "Happy Birthday" dhe i bëri një video. Pastaj ajo publikoi tjetër video, ku shfaqet me një lule në dorë, të cilën po e këpuste në drejtim të Geekut.

Ja si qëndron e vërteta e shtatzënisé së Khloe Kardashian



Prej disa ditësh në median rozë po qarkullon lajmi se Khloe Kardashian është në pritje të ëmbël. Deri këtu nuk ka asgjë të keqe, por kur u mësua se cili mund të ishte babai i fëmijës, rrjeti filloj të ziente. Qëkur ylli i "Keeping up with the Kardashians" është pajtuar me ish-partnerin e saj tradhtar Tristan Thompson, fansat kanë filluar t'i kundërvihen 36-vjeçares. Mesa duket

askush nuk dëshiron që lojtari i NBA-së të jetë në jetën e Khloes, sigurisht pas tradhtive të shumta kush do të donte që ajo të rikthehej sërisht me të. Megjithatë, burime pranë saj kanë konfirmuar për "E News" se Khloe nuk është shtatzënë. Edhe pse në fotot e publikuara së fundmi duket sikur ajo ka një bark të rrumbullakët, të afërmit tregojnë se thjesht duket kështu nga këndi i fotos.



Arta Nitaj nuk kursen pozat provokuese

Modeluesja e njohur shqiptare Arta Nitaj ka qenë një ndër personazhet më të përpopullore gjatë kësaj vere në media. Videot e ndryshme në "TikTok", imazhet provokuese nga plazhi dhe paraqitjet me


bikini, kanë bërë që bukuroshja me prejardhje nga Peja të jetë e shumë diskutuar në media. Së fundmi ajo publikoi disa imazhe të reja nga plazhi, ku shfaqet mjaft atraktive në bikini teksa trigon linjat trupore.

Azet publikon një tjetër këngë në duet me vëllanë



Azet është shumë aktiv me projekte të reja muzikore, të cilat apo priten shumë mirë në publik. Pas suksesit të këngës "Xhep", të cilin e solli në bashkëpunim me vël-

lanë e tij, Albin, reperi solli edhe një tjetër duet. "Zehnte Etage" titullohet kënga e re e Azetit në bashkëpunim me Albin, së cilës ia shoqëroi edhe videoklipin.



Llapi, kampion i afatit kalimtar

Skuadra e Tahir Batatinës, Llapi, është treguar më seriozja në afatin kalimtar, pasi ka transferuar 15 futbollistë. Ky klub do të tentojë ta rrëmbejë titull e kampionit. Edhe klubet e tjera janë treguar mjaft aktive për transferimin e futbollistëve

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Të enjten ka qenë dita e fundit e afatit kalimtar përfunduar në elitën e futbollit të Kosovës. Skuadrat e Superligës janë treguar mjaft aktive në këtë afat kalimtar edhe përkundër pandemisë Covid-19 e cila dukshëm ka dobësuar buxhetin e klubeve vendore, por edhe atyre ndërkombëtare. Skuadra e Llapit që nuk po arrin të garojë për titull edhe përkundër investimeve të bëra, në këtë afat kalimtar sërisht ka qenë në krye, duke sjell përforcime me bollëk.

Trajneri Tahir Batatina do të ketë punë për t'i zgjedhur më të mirët, pasi 15 futbollistë iu kanë bashkuar. Edhe Drita, Ballkani, Gjilani, Feronikeli e Prishtina kanë bërë mjaft transferime. Aktive kanë qenë edhe dy klubet që kanë siguruar inkuadrin në Superligë, Arbëria dhe Besa e Pejës.

Drita

Kampionia e Kosovës ka realizuar pesë transferime, të cilat janë mjaft cilësore. Gjilanasi e kanë rikthyer në Kosovë talentin Festim Alidema, por edhe Aarago Jamal. Kampionët janë përforçuar me Ergyn Ahmeti, Vladica Brdarovski dhe Valmir Azemi.

Gjilani

Pesë futbollistë ka transferuar edhe nënkompanioni i Kosovës, Gjilani. Ky klub ka transferuar Ivan Fustar, Enea Koliqi, Tomislav Sorsa, Ardit Hila, Shend Kelmendi dhe Arbëri Çyrba.

Ballkani

Transferime mjaft interesante ka realizuar edhe skuadra e Ismet Munishit, Ballkani. Suharekasit e kanë vazhduar huazimin e Mirlind Dakut edhe për një vit, kurse nga Prishtina kanë rrëmbyer kapitenin Armend Thaqi dhe Meriton Korenicën. Transferimet e tjera të këtij klubbi janë Nazmi Gripshi, Armin Bosnjak, Erduan Ibrahim, Leorant Marmullaku, Bajram Jashanica, Mevlan Zeka, Kenan Haxhihamza.



Prishtina

Trepça '89

Fituesja e Kupës së Kosovës, FC Prishtina, ka rikthyer futbollistët e spikatur Besnik Krasniqi, Behar Malqi dhe Mërgim Pefqeli. Transferime të mëdha nga kryeqytetasit janë edhe Sabjen Lilaj, Leutrim Kryzeziu, Albion Prapashtica, Nikson Memaj, Lumbard Dellova, Ivan Jeliç, Gledi Mici dhe Donat Hasanaj.

Feronikeli

Feronikeli ka dështuar t'i mbrojë titullin dhe Kupën, prandaj ka reaguar fuqishëm në afatin kalimtar. Klubi që drejtohet nga Afrim Tovërlani ka transferuar këtë futbollistë: Adem Malqi, Viktor Kuka, Bujar Pllana, Kresimir Kovacevic, Ozbej Kuhar, Alban Pnishi, Argjend Bardhi, Maraclei Santos, Ilir Avdyli, Bedri Greca, Marko Milickovic, Besmir Bojku.

Drenica

Drenica nga Skenderaj, që mezi e siguroi mbiqitesën në Superligë, transferoi mbrojtësin me përvjoje Lulzim Doshlaku dhe sulmuesin Almedin Murati. Pjesë e skuadrës nga Skenderaj do të jenë edhe Albutrint Morina, Jeton Dushi, Gentrit Hasi, Baton Zabergja, Valdo Zeqaj dhe Besfort Dervishaj.

Edhe skuadra e Trepçës '89 që mezi e siguroi mbiqitesën ka bërë disa lëvizje në transferimin e futbollistëve. Futbollistët Ervin Karac, Kreshnik Nebihu, Happy Mashau, Rilind Nimani dhe Sedat Berisha do ta djersitin fanellën e skuadrës nga Mitrovica.

Arbëria

Arbëria ka tejkular parashikimet duke u inkuadruar për herë të parë në histori të klubit në Superligë. Kjo skuadër ka angazhuar për edicionin e parë në elitë Sunaj Hasan, Willy Zambla, Ergon Hyseni, Labinot Ibrahim, Bruno Arrabal, Prince Mamboana, Donat Kaçi, Agron Bruqi, Gëzim Rusi, Arbëri Pira, Aladin Dakovaq.

Besa

Besa e Pejës pas dy vjetësh është rikthyer në Superligë. Kjo skuadër ka bërë disa transferime që pak njihen në opinion. Etnik Brruti, Redon Syla, Festim Haxhiu, Valton Ibrahim, Gentrit Salihu, Agron Kolaj, Ardi Ajdini, Ardit Tahiri, Ron Raqi, Diar Halili, Andi Alishiqi, Filip Sceki, Mbareck Ahmed Salem, Bilal Taghiyullah, H'meimar Ethmane, Lucas Sebastian Marques Da Silva do të jenë ata që do ta djersitin fanellën e pejanëve në Superligë.

SHKURT

Baseli 'blindon' Xhakën

Mesfushori Taluant Xhaka ka nënshkruar kontratë të re me Baselin deri në vitin 2024. Lajmi është konfirmuar nga klubi i madh zviceran. "Jam i entuziazmuar që Taulanti ka vazhduar kontratën edhe për tri vjet. Ai është pjesë e rëndësishme e klubit", ka thënë presidenti i klubit, Bernhard Burgener. E, gjithashtu, i lumtur për këtë kontratë të re është edhe mesfushori i Kombëtares shqiptare. "Është e vështirë ta shpreh me fjalë se sa shumë ka rëndësi përmua ky klub, ky qytet dhe fansat e mrekullueshmë të klubit. Jam krenar t'i mbroj ngjyrat e klubit", ka thënë Xhaka.

Lenjani prezantohet te Grasshoppersi

Futbollisti shqiptar Ermir Lenjani është prezantuar nga skuadra e Grasshoppersit. Mbrojtësi kuqezi ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me këtë skuadër, kurse në vitet e fundit me plot sukses luajti për Sionin. 31-vjeçari në të kaluarën ka luajtur edhe për Winterthurin, Nantesin, Stade Rennesin dhe St. Gallenin. Për Kombëtaren e Shqipërisë, Lajnani është paraqitur në 33 ndeshje dhe ka realizuar tri gola.

Zhegrova rikthehet te Genku

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Edon Zhegrova, është rikthyer në skuadrën e Genkut. Futbollisti "dardan" ishte i huazuar në skuadrën e Baselit, kurse me skuadrën belge ka kontratë deri në vitin 2021. "Një fytyrë e re te ekipi i Genkut, apo më mirë: një fytyrë familjare është kthyer. Edon Zhegrova është rikthyer te Genku pas një viti e gjysmë në huazim te Baseli", thuhet në njofimin e Genkut.

Aston Villa ofron 18 milionë për Rashicën

Werder Bremen po tenton ta shesë sa më parë Milot Rashicën dhe të përfitojë në aspektin financiar. Kalimi në Itali ka dështuar sikurse edhe në RB Leipzig. Kjo e fundit kishte ofruar 15 milionë euro plus tre bonuse, por Werder Bremen refuzoi menjëherë. Klubi që po këmbëngul më shumë për anësorin e "dardanëve" është Aston Villa dhe "Bild" raporton se anglezët po përgatitin një ofertë që kap shifrën e 18 milione eurove.

Vendosen 1 500 ulëse në stadiumin "18 Qershori"

Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka njofuar se në stadiumin "18 Qershori" janë vendosur 1 500 ulëse. Kryetari Elezaj ka treguar se po vazhdon puna për ndërtimin e fushës ndihmëse, projekt i cili do të përfundojë shumë shpejt. "Stadiumi i qytetit '18 Qershori', ku vitin e kaluar kemi bërë ndërtimin e tribunës lindore, kurse tash, pas pranimit të një donacioni nga MKRS-ja, është bërë edhe vendosja e 1 500 ulëseve, përvëç që po merr pamje më të bukur, edhe shikuesve po iu sigurohet ambient më i përshtatshëm për përcjelljen e ndeshjeve të Dukagjinit. Vendosja e ulëseve është realizuar nga punëtorët e KF Dukagjini të cilët i falënderojmë për angazhimin. Po ashtu, po vazhdon puna për ndërtimin e fushës ndihmëse, projekt i cili do të përfundojë shumë shpejt", ka shkruar Elezaj.

Basketbolli fillon me derbin Peja - Prishtina

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Të premten është bërë hedhja e shortit për edicionin 2020-2021 në Superligën e Kosovës në basketboll. Edicioni i ri do të fillojë më 21 tetor, kur edhe

do të zhvillohet xhiroja e parë. Ndërkohë, para fillimit të edicionit të ri në elitën e basketbollit do të zhvillohen ndeshjet e "play-out"-it ndërmjet Trepçës dhe AS

Prishtinës, ku fituesi do të garojë në Superligë. Në javën e parë do të ketë derbi në mes rivalëve të vjetër, Pejës dhe Sigal Prishtinës. Në takimet e tjera, Rahoveci e pret

Vëllaznimin që ka hyrë si fituese e Ligës së Parë, derisa Golden Eagle Ylli do të ballafaqohet me Ponte Prizrenin. Bashkimi do të ndeshet me Trepça - AS Prishtina.



Nënshkruhet marrëveshja për formimin e Ligës Unike

TIRANË, 11 SHTATOR - Në Tiranë është nënshkruar marrëveshja historike për formimin e Ligës Unike në basketboll në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëveshjen e kanë nënshkruar presidenti i FShB-së, Avni Ponari dhe kryetari i FBK-së, Arben Fetahu.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zbuluar logon dhe është shprehur se ky bashkëpunim duhet të thellohet edhe më shumë dhe të mos ketë ndarje mes dy vendeve. "Krijimi i Ligës Unike i çon gjërat në nivel tjetër në organizimin e aktivitetave të përbashkëta. Kam shpresë dhe besim që kjo do të bëhet shтыsë edhe për të tjerët. Aq për më tepër, në sport jemi të mëdhenj të jemi bashkë", u shpreh Rama.

Ai përgëzoi këtë iniciativë, duke qenë shembull edhe për sportet e tjera. "Liga Unike e Basketbollit është vetëm dallëndyshja e parë, e shumë bashkëpunimeve të ngjashme që do të ndodhin në sporte të tjera. Hapi i radhës është shtrirja e programit të masivizimit të sportit në shkolla në të dyja anët e kufirit. Në këtë mënyrë, fëmijët tanë,



vëllezër të të njëjtë gjak, do të kenë mundësinë që të njihen dhe bashkëpunojnë përmes sportit që në hapat e parë të jetës së tyre", theksoi Rama. Në këtë ceremoni shumë të rëndësishme kanë marrë pjesë edhe Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri dhe Vlora Dumoshi, ministre për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës. Para nënshkrimit të marrëveshjes është mbajtur mbledhja e parë e Bordit Drejtues. Anëtarë të Bordit Drejtues të Ligës Unike janë: Shaqir Totaj, Edmond Biqoku, Elvira Dushku, Korab

Llazani, derisa kryetar është zgjedhur Ilir Trebicka, një emër i njohur që ka dhënë shumë kontribut në basketbollin shqiptar apo edhe ikonë e basketbollit shqiptar. Bordi më pas e emëroi drejtorin e Ligës, Dren Zatriqin, kurse sekretar teknik është zgjedhur Fidan Hamiti. Ndërkohë, zyrtari i marketingut do të jetë Dren Hasangjekaj, kurse zyrtare e financave, Nadire Kajashi. Liga do të fillojë në muajin e ardhshëm dhe do të përbëhet nga tetë skuadra, katër më të mirat e Kosovës dhe katër më të mirat e Shqipërisë.

Lakersat, një fitore larg finales

ORLANDO, 11 SHTATOR - Los Angeles Lakersi ka treguar të gjithë forcën edhe në ndeshjen e katërt gjysmëfinale të Perëndimit ndaj Houston Rocketsit dhe tashmë kryeson bindshëm serinë e përballjeve mes tyre 3-1 me ndeshje. Në "AdventHealth Arena" të Orlando, Lakersat ishin superiorë ndaj Rocketsit në çdo aspekt duke dominuar në ndeshje. Diferencën e bënë dy periodat e para të lojës, me kalifornianët që në fundin e pjesës së parë e panë veten në avantazhin e 16 pikëve, duke administruar më pas takimin për të triumfuar me shifrat 110-100, raporton "SS".

Anthony Davis edhe në këtë sfidë i bëri siç duhet detyrat që i kishte ngarkuar trajneri Frank Vogel ashtu siç ka bërë në pjesën më të madhe të ndeshjeve të këtij sezoni. 29 pikë, 12 rebounde dhe 5 asistime koleksionoi në total ish-lojtari i Pelicans me Davis që ishte më i miri mbi parket



për Lakersat. Iu afroa shumë triple-double, ndërkohë LeBron James që koleksionoi në total 16 pikë, 15 topa të rikuperuar poshtë tabelës dhe 9 asistime. Në krahun tjetër Russell Westbrook realizoi 25 pikë për skuadrën teksane, Harden shtoi 21 të tjera, ndërsa Eric Gordon realizoi 19 pikë të pamjaftueshme gjithsesi për ta

evituar humbjen e tretë në katër takime ndaj Lakersave në "play-off" për Houstonin. Tashmë kalifornianët janë vetëm një fitore larg kualifikimit në finalen e Perëndimit që, sipas të gjitha gjasave, do të jetë një derbi kalifornian mes Lakersave dhe Clippersave ashtu siç parashikohej në fillim të sezonit.

SHKURT

Musolli braktis Kukësin për t'u rikthyer në Kosovë

Besar Musolli do të largohet pas tetë vjetësh nga Kukësi. Mesfushori pritet të largohet pas ndeshjes që Kukësi do të zhvillojë ndaj Wolfsburgut në turin e dytë të Ligës së Evropës do t'i japë lamtumirën skuadrës së Skënder Gegës për t'u vendosur në dispozicion të Gentjan Mezanit te Gjilani. Objektivat e Gjilanit në sezonin e ri janë të qartë. Do të synohet titulli kampion, pas vendit të dytë të sezonit të kaluar dhe për ta bërë këtë, Mezani ka nevojë edhe për lojtarë me përvojë të madhe mbi supe si Musolli në skuadrën e tij.

Cikalleshi nënshkruan kontratë dyvjeçare me Konyasporin

Sulmuesi i Shqipërisë, Sokol Cikalleshi, ka firmosur sot kontratë dyvjeçare për Konyasporin, skuadër e elitës së futbollit turk. "Ittifak Holding Konyaspor firmos kontratë me Sokol Cikalleshi, i cili luan në pozicionin e qendërsulmuesit. Më saktesh kemi nënshkruar marrëveshje zyrtare, që e lidh atë me klubin tonë për dy vjet. Cikalleshi, i cili ka luajtur 303 ndeshje në karrierën e tij, arriti të shënonte 92 gola në të gjitha garat. Ai ka luajtur 35 herë me kombëtaren e Shqipërisë, duke shënuar 7 gola. Transferimi ynë i ri, Cikalleshi, do ta veshë fanellën me numrin 17", thuhet në njoftimin e Konyasporit.

Koemani kërkon katër futbolliste

Trajneri Ronald Koeman ua ka dorëzuar drejtuesve të Barcelonës një listë me katër lojtarë për t'i transferuar në këtë afat kalimtar. Sipas gazetës spanjolle "Marca", tre lojtarë që Koeman i dëshiron janë holandez. Sulmuesi i Lyonit, Memphis Depay, është i pari në listë, pastaj mesfushori i Liverpoolit, Georginio Wijnaldum. Gjithashtu, edhe mbrojtësi i Interit, Stefan de Vrij dhe Eric Garcia i Manchester Cityt.

Milani i hyn garës për Bale

Tottenham Hotspur do ta ketë konkurrencën e Milanit në garë për transferimin e yllit të Real Madridit, Gareth Bale. Sulmuesi uellsian i cili ka përfunduar jashtë planeve të Zinedine Zidane dhe Reali po tenton ta shesë në këtë afat kalimtar. Kuqezinjtë po ndërtojnë një skuadër të denjë për të siguruar një vend në Champions League sezonin e ardhshëm dhe, pse jo, të tentojnë të jenë rivalë edhe në garën për titull në Serinë A dhe pas rinnovimit me Ibrahimoviq apo edhe afrimeve të lojtarëve të talentuar si Sandro Tonali e Brahim Diaz, kërkojnë të afrojnë edhe një kampion si Bale për të tentuar një sezon të suksesshëm.

Rossi: Nuk pensionohem, 99 % do të garoj me këtë skuadër

Piloti italian Valentino Rossi ka hedhur poshtë spekulimet se ai do të tërhiqet nga sporti në fund të këtij sezoni. 42-vjeçari do të largohet nga Yamaha në fund të këtij sezoni, por jo nga sporti. Ai ka konfirmuar se është pranë nënshkrimit me Yamaha Petronas. "Situata është ajo e tri javëve më parë, kur u ndal sezoni prej pushimeve. Me Yamaha kam kohë që bisedoj, duhen mbyllur edhe disa detaje të vogla. Me 99 % do të garoj me Yamaha Petronas sezonin tjetër. Ndoshta në Barcelona, pas 10 ditësh, do të bëjë zyrtar vendimin tim", ka thënë Rossi. "Ndoshta dikush shpreson që unë të mos qëndroj më në Moto GP. Lajmi i pensionit tim do të ishte një lajm i madh, ndaj dikush e ka shpikur për të qenë më i lexueshëm në media. Këtu nuk ka asgjë të vërtetë. Do të vazhdoj të garoj", ka shtuar Rossi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Ajencija për Investime dhe Përkratjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
 Agencija za Investicione i Podrsku Preduzeča na Kosovu (KIESA)
 Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të përkrahjes se ndërmarrësë me pronësi apo me bashkëpronësi (së paku 50%) të grave ndërmarrëse, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkratjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për subvencionim të NVM-ve me pronësi të grave ndërmarrëse

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, dhe me qëllim të fuqizimit të bizneseve me pronësi apo me bashkëpronësi (së paku 50%) të grave ndërmarrëse, shpallim thirrje të hapur publike për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

MTI/KIESA do të mbështesë në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet sipas kategorive si në vijim:

- Për ndërmarrjet mikro (të punësuar 1 deri 9 punëtor), vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje mikro është deri në 75% e vlerës së projektit ose në vlerë financiare maksimumi deri në 10,000.00 EURO.
- Për ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri 49 punëtor), vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e vogël është deri në 50% e vlerës së projektit ose në vlerë financiare maksimumi deri në 20,000.00 EURO.
- Për ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri 249 punëtor) vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e mesme është deri në 50 % e vlerës së projektit ose në vlerë financiare maksimumi deri në 30,000.00 EURO.

Aplikuesi i cili aplikon për subvencione dhe transfere në Ministri, duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës.

1. Për të aplikuar duhet plotësuar Aplikacionin (*shkarko në web*) më të dhënat bazike të subjektit aplikues dhe duhet të dorëzoj dokumentacionin sipas UA (MTI) 01/2018 dhe kërkesave shtesë, si në vijim:
 - 1.1. Deklaratën nën betim (duhet të jetë e vulosur nënshkruar) (*shkarko në web*);
 - 1.2. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informata përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
 - 1.3. Certifikatën e numrit fiskale (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikat);
 - 1.4. Vërtetimet tatumore me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatumore të pashyera apo obligime tjera tatumore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK;
 - 1.5. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi;
 - 1.6. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore – kërkohet originali jo më i vjetër se 30 ditë;
 - 1.7. Dëshminë e xhirologarisë aktive të aplikuesit në njëren prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
 - 1.8. Gjendjen e xhirologarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit. Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme;
 - 1.9. Projekt-propozimi që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare si dhe planin kohor të realizimit të projektit dhe strukturën organizative të aplikuesit;
 - 1.10. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitet, (e dëshmuar më deklaratën nën betim);
 - 1.11. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MTI për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratën nën betim);
 - 1.12. Lista e të punësuarve aktual (jo me e vjetër se 30 ditë nga shpallja publike) e dëshmuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Në bazë të së cilës listë do të kategorizohen si ndërmarrjet mikro, e vogël dhe e mesme. **Sqarim:** Ndërmarrjet që kanë mbi 249 punëtor, diskualifikohen.

Sqarim: Ju lutem vini re se në mungesë të cilidto dokument të kërkuar me lartë, subjektet aplikues do të diskualifikohen dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e vlerësimit të listuara më poshtë.

2. Kriteret e vlerësimit:

2.1 Të ardhurat bruto, marrin maksimum 20 pikë:

- ndërmarrjet mikro marrin nga një (1) pikë për çdo 2,000.00 EUR të ardhura bruto,
- ndërmarrjet e vogla marrin nga një (1) pikë për çdo 20,000.00 EUR të ardhura bruto,
- ndërmarrjet e mesme marrin nga një (1) pikë për çdo 100,000.00 EUR të ardhura bruto.

Të ardhurat bruto të dëshmohen nga Administrata Tatimore e Kosovës prej janar 2020 e deri me rastin e aplikimit në këtë thirrje publike.

2.2 Vlera e bashkëfinancimit të projektit investiv nga ana e ndërmarrjes, marrin maksimum 25 pikë:

- ndërmarrjet mikro marrin nga tri (3) pikë për çdo 500.00 EUR të deklarimit të bashkë investimit të vlerës së projektit.
- ndërmarrjet e vogla marrin nga një (1) pikë për çdo 800.00 EUR të deklarimit të bashkë investimit të vlerës së projektit.
- ndërmarrjet e mesme marrin nga një (1) pikë për çdo 1,000.00 EUR të deklarimit të bashkë investimit të vlerës së projektit.

Vlera e bashkëfinancimit të vlerës së projektit investiv duhet të dëshmohet me dëshmi bankare (gjendja bankare e nënshkruar dhe e vulosur) apo me “letër referencë” nga banka (nënshkruar dhe vulosur), e cila dëshmon që do të bashkë financoj projektin e subjektit aplikues në rast që do të përfitoj subvencionimin në fjalë.

2.3 Planifikimi i punësimit, maksimum 30 pikë,

- ndërmarrjet mikro marrin nga tetë (8) pikë për çdo një (1) që do të punësojë;
- ndërmarrjet e vogla marrin nga pesë (5) pikë për çdo një (1) që do të punësojë;
- ndërmarrjet e mesme marrin nga tre (3) pikë për çdo një (1) që do të punësojë.

Numri që planifikohet të punësohet duhet të dëshmohet me deklaratë me shkrim (nënshkruar dhe vulosur), e cila më pastaj për ndërmarrjet përfituese do të jetë pjesë e marrëveshjes.

2.4 Maksimumi 25 pikë, me projekt-propozime dëshmojnë që subvencionet e ndara do të ndikojnë në:

- Rritjen e investimeve në Republikën e Kosovës;
- Rritjen e prodhimtarisë vendore;
- Rritjen e eksportit;
- Promovimin e turizmit;
- Zhvillimin e NMVM-ve;
- Rritjen e kapaciteteve konkurruese të NMVM-ve;
- Hapjen e vendeve të reja të punës.

Vëmendje:

- ✓ Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MTI/KIESA dhe ndërmarrje), pjesë e secilës do të janë edhe deklarimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- ✓ TVSH është shpenzim i pranueshmë vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje jo deklaruese të TVSH-së. Për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshmë.
- ✓ Ndërmarrjet mund të përfitojnë vetëm një grant.
- ✓ Vlerësimi i aplikacioneve zhvillohet ndërmjet kategorive përkatëse si mikro me mikro, të vogla me të vogla dhe të mesmet me të mesme.
- ✓ Përfitues do të janë ato ndërmarrjet që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësish prej limiteve buxhetore të planifikuara.
- ✓ Pronësia e ndërmarrjeve duhet të jetë e definuar para hapjes se kësaj thirrje publike dhe nuk pranohen ndryshim-plotësimë në pronësi pas hapjes se kësaj thirrje publike.

Periudha e aplikimit:

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mti.rks-gov.net dhe KIESA-s kiesa.rks-gov.net. Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në zyrën e arkivit të Ministrisë në formë fizike dhe në CD, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Rr. Muhamet Fejza, Lagjja e Spitalit, p. n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Afat i fundit për shprehje të interesit është deri më datë 02.10.2020 në orën 16:00 dhe aplikimet pas këtij orari nuk pranohen nga zyra e Arkivit të Ministrisë.

Informata dhe sqarime shtesë mund të merren përmes postës elektronike në: sme.kiesa@rks-gov.net konform U.A.01/2018, por jo më vonë se pesë (5) ditë para mbylljes se thirrjes publike.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Salon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrie - Ministry of Trade and Industry

Ajencija për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Agjencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)

Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

U cilju podržavanja preduzetništva u vlasništvu ili u suvlasništvu (najmanje 50%) žena preduzetnika, Ministarstvo Trgovine i Industrije preko Agencije za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA) objavljuje:

Javni poziv za subvencije za MSP u vlasništvu žena preduzetnika

Na osnovu Administrativnog Uputstva (MTI) br. 01/2018 o Raspodelu Finansijskih Sredstava od Ekonomiske Kategorije Subvencije i Transfera, i suvlasništvu (najmanje 50%) žena preduzetnika, objavljujemo otvoreni javni poziv za podršku mikro, malim i srednjim preduzećima.

MTI/
kategorijama:

- (koja imaju zaposlena 1 do 9 radnika), maksimalna vrednost 75% od vrednosti projekta ili u finansijskoj vrednosti maksimalno do 10.000,00 EVRA.
- Za mala pr (koja imaju zaposlena 10 do 49 radnika), 50% od vrednosti projekta ili u finansijskoj vrednosti maksimalno do 20.000,00 EVRA.
- (koja imaju zaposlena 50 do 249 radnika) 50% od vrednosti projekta ili u finansijskoj vrednosti maksimalno do 30.000,00 EVRA.

Podnositac aplikacije koji se prijavljuju za subvencije i transfere u Ministarstvu, moraju biti registrovani u Republici Kosovo.

1. Da biste aplicirali, treba ispuniti Aplikaciju (*preuzmite na vebu*) sa osnovnim podacima aplikanta i treba dostaviti dokumentaciju prema AU (MTI) 01/2018 i dodatnim zahtevima, kao što sledi:
 - 1.1. Izjavu pod zakletvom (potpisom i pečatom) (*preuzmite na vebu*);
 - 1.2. Sertifikat o registraciji poslovanja sa svim pratećim informacijama u skladu sa zahtevima važećeg zakonodavstva u Republici Kosovo;
 - 1.3. Sertifikat o fiskalnom broju (ne važi za preduzeća koja broj registracije poslovanja i fiskalni broj imaju u jednom Sertifikatu);
 - 1.4. Poreska potvrda kojom se potvrđuje da podnositac aplikacije trenutno nema neizmirenih poreskih dugova ili druge poreske obaveze, ili je sa PAK-om zaključio sporazum o izmirenju duga;
 - 1.5. Kopiju lične karte lica na čije ime je podnositac aplikacije registrovan;
 - 1.6. Uverenje od podnosioca aplikacije da nije u stecaju ili pod prinudnom sudskom upravom, izdatu od strane Osnovnog Suda traži se original, ne stariji od 30 dana;
 - 1.7. Dokaz o aktivnom računu podnosioca aplikacije u jednoj od licenciranih banaka od strane Centralne Banke Kosova;
 - 1.8. Stanje na bankovnom računu podnosioca aplikacije za poslednju godinu. Za novoosnovane podnosioce aplikacije ovo nije primenjivo;
 - 1.9. Nacrt predloga koji obuhvata: svrhu, aktivnosti projekta, finansijske troškove i vremenski rok za realizaciju projekta, kao i organizacionu strukturu podnosioca aplikacije;
 - 1.10. Da nije primio sredstva iz drugih izvora finansiranja za iste aktivnosti (potvrđuje se davanjem izjave pod zakletvom);
 - 1.11. Da su ispunili sve obaveze iz prethodne finansijske podrške, ako su ostvarili korist iz javnih izvora finansiranja MTI-a u poslednje dve godine, (potvrđuje se davanjem izjave pod zakletvom);
 - 1.12. Lista trenutno zaposlenih (ne starija od 30 dana od javnog oglasa) overen od strane Poreske Administraciju Kosova. Na osnovu koje liste biće kategorisana kao mikro, mala i srednja preduzeća. **Pojašnjenje:** Kompanije sa više od 249 zaposlenih su diskvalifikovane.

Pojašnjenje: Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog od gore zahtevanih dokumenata, podnosioci aplikacije će biti diskvalifikovani i neće biti dalje razmatrani za dole navedene kriterijume za ocenjivanje.

2. Kriterijumi ocenjivanja:

2.1 Bruto godišnji prihod, dobijaju maksimalno 20 poena:

- mikro preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 2,000.00 EUR bruto prihoda,
- mala preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 20,000.00 EUR bruto prihoda,
- srednja preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 100,000.00 EUR bruto prihoda.

Bruto prihode treba da dokaže Poreska Administracija Kosova od januara 2020 godine do prijave u ovom javnom pozivu.

2.2 Vrednost kofinansiranja vrednosti investicionog projekta od strane preduzeća, dobijaju maksimalno 25 poena:

- mikro preduzeća dobijaju po tri (3) poena za svakih 500.00 EVRA izjave o kofinansiranju vrednosti projekta.
- mala preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 800.00 EVRA izjave o kofinansiranju vrednosti projekta.
- srednja preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 1,000.00 EVRA izjave o kofinansiranju vrednosti projekta.

Vrednost kofinansiranja vrednosti investicionog projekta treba biti dokazana bankarskim dokazima (bankovno stanje potpisano i pečatom) ili „referentnim pismom“ banke (potpisano i pečatom), koje dokazuje da će kofinansirati projekat aplikanta u slučaju dobijanja dotične subvencije.

2.3 Planiranje zapošljavanja, maksimalno 30 poena,

- mikro preduzeća dobijaju po osam (8) poena za jednog (1) kojeg će zaposliti;
 - mala preduzeća dobijaju po pet (5) poena za jednog (1) kojeg će zaposliti;
 - srednja preduzeća dobijaju po tri (3) poena za jednog (1) kojeg će zaposliti;
- Broj koji se planira zaposliti mora se dokazivati pismenom izjavom (potpisom i pečatom), koja će zatim biti deo sporazuma za preduzeća koja su korisnice.

2.4 Maksimalno poena, sa projektnim predlozima koji dokazuju da će dodeljene subvencije uticati na:

- Povećanje investicija u Republici Kosovo;
- Povećanje domaće proizvodnje;
- Povećanje izvoza;
- Promovisanje turizma;
- Razvoj MMSP-a;
- Povećanje konkurentnih kapaciteta MMSP-a;
- Otvaranje novih radnih mesta.

Pažnja:

- ✓ U slučaju da će preduzeće biti korisnik, onda će biti potpisani bilateralni sporazum (MTI/KIESA i preduzeće), deo svakog od njih će biti izjave date prilikom apliciranja.
- ✓ PDV je prihvatljiv trošak samo za fizička lica i preduzeća koja nisu deklarativna za PDV. Za preduzeća koja su deklarativna za PDV, to je neprihvatljiv trošak.
- ✓ Preduzeća mogu dobiti samo jedan grant.
- ✓ Ocenjivanje aplikacije odvija se između odgovarajućih kategorija kao što su mikro sa mikro, mala sa malim i srednja sa srednjim.
- ✓ Korisnici će biti preduzeća koja ocenjivačka komisija ocenjuje sa najviše poena, zavisno od planiranih budžetskih ograničenja.
- ✓ Vlasništvo nad preduzećima mora biti definisano pre otvaranja ovog javnog poziva i ne prihvataju se izmene-dopune u vlasništvu nakon otvaranja ovog javnog poziva.

Period apliciranja:

Saopštenje za javni poziv objavljeno je na web stranici Ministarstva Trgovine i Industrije mti.rks-gov.net i KIESA kiesa.rks-gov.net. Subjekti koji se žele prijaviti na javni poziv treba da iskažu svoje interesovanje podnoсеći svu dokumentaciju u arhivu Ministarstva u fizičkom obliku i na CD-u, u Ministarstvu Trgovine i Industrije, Ul. Muhamet Fejza, bb. Bolničko Naselje, Priština, 10000, Republika Kosovo.

Zadnji rok za iskazivanje interesa je do 02.10.2020 u 16:00 časova, a prijave nakon tog roka neće biti prihvocene od Arhiva Ministarstva. Dodatne informacije i pojašnjenja mogu se dobiti putem e-maila na: sme.kiesa@rks-gov.net u skladu sa A.U. 01/2018, ali ne kasnije od pet (5) dana pre završetka javnog poziva.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese
për shtëpi. Shtëpi është
në Prishtinë. Çmimi
sipas marrëveshjes.
Informatat në tel:
045-336-731**

► "Albesi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330259483.

► Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballe EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehje qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afér 60 m2, katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira përfunduar. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet përfunduar. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjnë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira përfunduar apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përballe "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpianë kati i parë, posedon tre shtëpi dhe e mobiluar. Preferohen përfunduar studentë, një qift apo tjetër. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet përfunduar, preferohen përfunduar studentë, mund të merret përfunduar kohë tjetër. Çmimi është 180 €uro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentish kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të niko kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NDËRMARRJA E RE "MIM GOLESH" Magure - Lipjan

SHPALLJE PËR SHITJEN E MATERIALEVE NGA DUNITI

Ndërmarrja e Re "Mim Golesh" Magure – Lipjan , e cila është në Administrim të Drejtëpërdrejt të AKP-së,

SHPALLË:

FTESE PËR OFERTE

I. LËNDA E KONTRATËS

1. Shitia e materialeve nga dunitet (shkëmbinj vulkanik) në masë kompakte (masë natyrale), sasia afër 350,000.00 m³

KUSHTET E OFERTIMIT PËR BLERJEN E MATERIALAVE NGA DUNITET

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal për Operatoret Ekonomik, kopja e letërnjoftimit për personat fizik;
- Çmimin e ofruar;
- Oferta duhet të jetë shumë e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuar, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik apo personi fizik.

II. VIZITA NË NDËRMARRJE PËR TË PARË VENDIN KU NDODHEN DUNITET NE MASË KOMPAKTE

Palët e interesuara mund të vizitojnë hapësirat e ndërmarrjes ku gjinden materialet e shpallura për shitje dunitet (shkëmbinjet vulkanik) prej datës 12 shtator deri me 16 shtator 2020. Personi kontaktues për shikimin fizik të dunateve është z. Shefik Imeri 045/ 669-479 dhe Sejdi Hasi 044/842-229. Personat e lartpërmendur mund te kontaktohen edhe telefon fix. 038/588-700.

III. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES:

- Çmimi më i lartë për m³ masë kompakte të dunateve. Ofertesi përpërsërit për dunitet duhet të paguaj edhe vlerën e rentës minerale prej 0.5 euro për m³ masë kompakte plus Tvh.
- Operatori ekonomik fitues duhet te depozitoj edhe Garacionin e sigurimit të kontratës që duhet të jetë 10% nga vlera e ofertës.

AFAFI KOHOR DHE VENDI PËR DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të janë në zarf të myllur, duhet të dërgohen me datën **16.09.2020** nga ora **13⁰⁰** deri në orën **14⁰⁰** në adresën e mëposhtme Agjencja Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr. 23, Prishtine.

Ofertat do të hapen me datën **16.09.2020** në ora **14¹⁵** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr. 23, Prishtinë.

VI. Përfaqësuesit legitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.



Korporata Energetike e Kosovës S.p.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KOMPANIJA KOSOVA D.D.

Divizioni i Burimeve Njerezore në Korporaten Energetike të Kosovës (KEK sh.a.) jepë këtë njoftim;

NOFTIM

PËR ANULIMIN E SHPALLES PUBLIKE

Noftohen të gjithë aplikuesit që kanë aplikuar në shpalljen publike numër të protokolit 1843 të dates 09.03.2020 e publikuar në adresen elektronike të KEK-ut dhe në gazeten ditore Epoka e Re, se anulohet shpallja publike me numer protokolit 1843 e dates 09.03.2020 për arsyet e shfaqjes së pandemisë dhe marrjen e masave nga Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me kufizimin e lëvizjes së lirë dhe organizimin e tubimeve publike të qytetarëve gjatë kohes së pandemisë në periudhen kohore që është dashur të bëhet testimi dhe intervistimi i kandidatëve të cilet kanë aplikuar në shpallje publike të cekur më lartë. Prandaj për këtë arsyet nuk kemi pasur mundësi të zhvillimit të procedurave në bazë të afateve te caktuara kohore.

Prishtinë 11.09.2020

Divizioni I Burimeve Njerezore
Korporata Energetike e Kosovës sh.a.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministerstvo za Finansije - Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



11.09.2020

Njoftim për tatimpagues

Trajtimi i kërkesave për Rimbursim

Administrata Tatimore e Kosovës, ju ri-njofton se nga data 01 qershor 2018 është publikuar versioni i ri i Sistemit Elektronik – EDI, i cili ofron edhe shërbimin – Menaxhimi i Rimburimeve.

Shërbimi i ri elektronik për Menaxhimin e Rimburimeve është funksionalizuar në sistemin elektronik EDI, dhe është në disponicion për tatimpaguesit, të cilët bëjnë kërkesë për Rimbursim, si: për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin në të Ardhura Personale (TAP) dhe Tatimin në të Ardhura të Korporatave (TAK).

Përmes këtij shërbimi, tatimpaguesi mund të informohet se deri ku arritur të shqyrtohet nga ATK, kërkesa e tij për Rimbursim e dërguar më parë. Më konkretisht përmes shërbimit "Menaxhimi i Rimburimeve", tatimpaguesi mund të informohet për:

- Datë e kërkesës për Rimbursim;
- Vlerën e kërkuar;
- Llojin e tatimit;
- Statusin e shqyrimit të kërkesës (Në pritje / Përfunduar / Refuzuar);
- Kategorizimin e tatimpaguesit sipas Rregullores së brendshme të ATK-së, A; B apo C;
- Datën e përfundimit, dhe
- Vlerën e aprovuar.

Në funksion të ngritisë së efikasitetit dhe efektivitetit për zbatimin e dispozitiveve ligjore lidhur me rimbursimet, ATK ka themeluar Divisionin për Menaxhimin e Rimburimeve. Ky Division menaxhon komplet procesin e rimburimeve nga një qendër e vetme në Zyrën Qendrore të ATK, përmes Modulit të Rimburimit. Përmes këtij Moduli, bazuar në kriteret e përcaktuara nga ATK, të gjitha kërkesat për rimbursim në mënyrë automatike nga vet sistemi, kategorizohen në tri kategori, si: A, B dhe C.

Divizioni i Rimburimeve menaxhon direkt me kërkesat për rimbursim për tatimpaguesit e kategorizuar në A dhe B, ndërsa kërkesat për tatimpaguesit e kategorizuar në C delegohen nga Divizioni i Rimburimeve në Drejtorit Rajonale për trajtim përmes procedurës së Kontrollit Tatimore.

Bazuar në Rregulloren e brendshme të ATK-së, për Procedurat e Rimburimit, shqyrimi i kërkesës për rimbursim, nga ATK, do të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit së kërkesës së tatimpaguesit.

Administrata Tatimore e Kosovës



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshepeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ROYAL CROWN®

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

0.5L